



FLET PËR "EPOKËN E RE" KËSHILLTARI I KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË, LULZIM RAFUNA ■ FAQE 4-5

Dogana Shqipëri - Kosovë, një dritare e vetme

- Nga muaji mars Shqipëria dhe Kosova do ta kenë një pikë të përbashkët doganore Morinë - Vermicë

Lulzim Rafuna, këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë për dogana dhe tatime, ka thënë se bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ka avancuar shumë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ish-drejtori i Doganës

së Kosovës ka bërë me dije se në muajin e ardhshëm do të ketë lehtësira doganore ndërmjet dy vendeve. Sipas Rafunës, tani do të jetë një pikë e përbashkët doganore Kosovë - Shqipëri në kufirin Morinë - Vermicë. "Këtu do ta kemi

ndryshimin më të madh në muajin e ardhshëm, ku do t'i vendosim të dyja doganat në një dritare të vetme", ka thënë Rafuna, duke bërë me dije se të dyja qeveritë janë duke ndërmarrë veprime për t'i eliminuar burokracitë institucionale



Prof. dr. Emin KABASHI

AKTUALE

KOSOVA DHJETËVJEÇARE DHE IDENTITETI KOMBËTAR F.16-17



THAÇI: KOSOVA DO TË JETË ANËTARE E OKB-SË F. 6

KRYETAR I SBASHK-ut RIZGJEDHET RRAHMAN JASHARAJ F. 6


EKONOMI

HARADINAJ NË SAMITIN E LONDRËS PREZANTON MBI 30 PROJEKTE F. 9

RESHITAJ, KRYETARËVE TË KOMUNAVE: PROJEKTET KAPITALE NUK JANË MENAXHUAR SI DUHET F. 10

KULTURË

LOLA KALTRINA LANSOI KËNGËN 'PIKTURA' F. 13



SPORT

DRITA MERR KRYESIMIN NË ELITË F. 20

UNITEDI TRIUMFOI NË "OLD TRAFFORD" F. 20



Beteja e demarkacionit, për tri vota

Koalicioni qeverisës ka siguruar votat e deputetëve të LDK-së, por jo edhe të deputetëve të Listës Serbe, që është pjesë e këtij koalicioni, për ratifikimin e demarkacionit me

Malin e Zi. Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se deputetët e saj nuk do ta votojnë demarkacionin, ndërsa tani kryeministrit Haradinaj i mbetet t'i sigurojë votat e Listës

Serbe. Për kalimin e kësaj marrëveshje nevojiten mbi 80 vota, ndërsa me pajtimin në mes të PDK-së, AAK-së, Nismës dhe LDK-së janë siguruar 78 vota ■ FAQE 4-5

Sot vazhdon dialogu Kosovë - Serbi

■ FAQE 3

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Junckeri nis vizitën në Tiranë, pritet nga kryeministri Rama

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, të dielën në Tiranë është pritur nga kryeministri Edi Rama në kuadër të vizitës në Ballkanin Perëndimor, për ta promovuar strategjinë e re të BE-së për këtë rajon. Sot (e hënë) Junckeri do të takohet me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta

TIRANË, 25 SHKURT - Turi i takimeve të presidentit të Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker në Ballkan ka vijuar të dielën në Tiranë, ku rreth orës 18:00 është pritur nga kryeministri Edi Rama në godinën e qeverisë. Vizita e Junckerit në gjashtë shtete të Ballkanit, të cilat janë jashtë Bashkimit Evropian, ka nisur në Maqedoni, ku është takuar me kryeministrin e këtij vendi, Zoran Zaev.

Vizita e Junckerit në këtë rajon vjen pas vizitës së ministrit të Jashtëm rus Sergei Lavrov në Beograd, i cili ka deklaruar marrëdhëniet e ngushta të vendit të tij me Serbinë. Gjatë vizitës së tij, Lavrovi ka përhëndetur rrugën e Serbisë për në BE, mirëpo ka premtuar se Moska do të jetë e

lidhur me këtë vend, pavarësisht prej ndodhjeve të tjera.

Turi i takimeve të presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, nisi të dielën në Tiranë, ku do të ketë një sërë takimesh. Në orën 17:30 organizohet ceremonia ushtarake e pritjes në Tiranë nga kryeministri Edi Rama. Më pas, në orën 19:15, do të zhvillohet konferenca për shtyp mes kryeministrit Edi Rama dhe presidentit Juncker.

Sot (e hënë) në mëngjes presidenti Jean-Claude Juncker do të takohet me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Pritet me interes mesazhi që Junckeri do t'i japë klasës politike, pasi vendi është cilësuar nga Evropa, si një Kolombi e dytë. Nga ana tjetër, shqiptarët kanë pushuar vendet



si: Franca dhe Britania, duke mbajtur rekord të numrit të kërkesave për azil. Por, edhe çështja "Tahiri" mund të konkludohet në mesazhe jo të mira për vendin.

Kreu i Komisionit Evropian, Zhan Klod Juncker, i shoqëruar nga eurokomisioneri për zgjerim dhe

fqinjësi të mirë, Johannes Han, të dielën ka qëndruar edhe në Shkup. Në konferencë të përbashkët për shtyp me kryeministrin Zoran Zaev, Junckeri tha se sot nuk ka ardhur për ta caktuar datën e hapjes së bisedimeve me BE-në, por për të thënë se Maqedonia është në rrugë të

drejtë.

Junckeri nuk deshi të flasë për çështjen e emrit duke thënë se ajo është një çështje që duhet të zgjidhet nga vetë Maqedonia dhe Greqia. Kreu i Komisionit Evropian shtoi se Maqedonia kohët e fundit ka bërë shumë reforma të cilat kanë habitur botën.

Nga ana tjetër, Zaev falënderoi zyrtarët e BE-së që zgjodhën Maqedoninë si vendin e parë për ta filluar turin e tyre ballkanik. Zaevi edhe një herë u shpreh i bindur se në qershor vendi do t'i nisë bisedimet për integrim në BE dhe tha se kanë mbetur edhe pak aktivitete kyçe që ky të jetë një vend historik për Maqedoninë.

Më herët, këtë muaj, Komisioni Evropian publikoi strategjinë e re për integrimin e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës në BE. Në mesin e këtyre vendeve, Serbia dhe Mali i Zi janë përmendur si vendet më të afërta për t'u anëtarësuar në bllok deri më 2025, nëse i plotësojnë të gjitha kushtet.

Vasili: Rama orienton vendin larg BE-ja dhe ShBA-ja



TIRANË, 25 SHKURT - Keqorientimi në rrafshin strategjik të diplomacisë shqiptare është ekstrakti që paraqet postimi më i fundit i kreut të Grupit të LSI-së, Petrit Vasili, i cili akuzon kryeministrin Rama si fajtor për dëmtimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me BE-në dhe ShBA-në. "Për shkak të një kryeministri peng interesash të errëta Shqipëria sot gjendet në çorientimin më të rëndë dhe të qëllimshëm strategjik dhe kombëtar si asnjëherë në këta 27 vjet pluralizëm. Orientimi strategjik madhor drejt ShBA-së është sot jo vetëm i dyzuar, por edhe i shantazhuar", shprehet Vasili. Sipas tij, shqiptarëve po u vihen në

tavolinë "realitete ekstramerikane të lyera me bojën e interesave ekonomike të zymta, si zgjidhje më të 'embla' dhe më të 'këndshme' sesa sprova e demokracisë së fortë, parimore dhe të panegociueshme amerikane, e cila e shëndosh Shqipërinë dhe e bën atë një realitet të qëndrueshëm politik-social".

Duke vendosur në qendër të akuzave të tij kryeministrin Rama, Vasili thekson se ekziston një logjikë e parave, e cila po dominon mbi demokracinë e vendit edhe marrëdhëniet me BE-në, duke shantazhuar kështu edhe raportin me Unionin. "Çdo

kërkesë për vendosjen e shtetit ligjor nga ShBA-ja dhe BE-ja po shantazhohet nga kryeministri dhe ata që e ndjekin pas me kërcënimin shumë të rrezikshëm se 'do të shkojmë andej nga na japin para', pavarësisht erës shpesh të qelbur të tyre, që natyrisht nuk janë as dollarë dhe as euro, por para të tjera gjithfarësh", tha Vasili. Logjika e ish-kreut të LSI-së shkon drejt influencave të Rosisë dhe Turqisë mbi Qeverinë shqiptare, një teori të cilën ai e mbështet te votimi kundër Amerikës në OKB apo deklaratat e kryeministrit në Bruksel se "nuk presim gjatë BE-në dhe do të shohim edhe alternativat të tjera".

Xhaçka: Vlerësim sipas meritës dhe trajtim dinjitoz për ushtarakët

TIRANË, 25 SHKURT - Vlerësim dhe promovim në bazë të meritokracisë dhe trajtim përherë e më tepër dinjitoz për ushtarakët shqiptarë, ishte mesazhi kryesor që ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ua dha efektiveve të batalionit të tretë të këmbësorisë në Poshnje, gjatë qëndrimit të saj në Berat, në kuadër të mbledhjes së qeverisë në këtë qark.

Në vizitën e saj në batalionin e tretë të këmbësorisë, ministrja Xhaçka shoqërohej nga zëvendësministri Petro Koçi dhe

komandanti i Forcës Tokësore, generalbrigade Nazmi Cahani. Fillimisht ministrja Xhaçka falënderoi të gjithë efektivet e këtij batalioni për angazhimin dhe kontributin e tyre në përmbajtjet e fundit, sidomos tani që Emergjencat Civile janë nën përgjegjësinë e institucionit që ajo drejton. "Dua të ndalem pak tek Emergjencat Civile që tashmë janë fushë përgjegjësie e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse e kam parë kontributin, dedikimin, përkushtimin, profesionalizmin e

gjithsecilit prej jush në ato operacione shumë të vështira në fillim të dhjetorit, kryesisht në zonën e Fierit dhe të Vlorës, por edhe këtu në Berat me punën e jashtëzakonshme që ka bërë gjithsecili prej jush për t'u ardhur në ndihmë atyre banorëve që vuajnë nga pasojat e motit të keq", tha ministrja Xhaçka, e cila u shpreh se ishte në dijeni të vështirësive dhe nevojave të ushtarakëve dhe për të cilat shprehu angazhimin e saj për një trajtim më dinjitoz për secilin prej tyre.



Në Bruksel sot (e hënë) do të mbahet takimi i radhës i dialogut teknik në mes të delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë

Sot vazhdon dialogu Kosovë - Serbi

Dialogu teknik në mes të delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë pritet të vazhdojë sot (e hënë) në Bruksel. Temë e diskutimit në këtë takim do të jetë zbatimi i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe tabelat e regjistrimit të automjeteve, menaxhimi i vendkalimeve kufitare dhe zbatimi i marrëveshjes për gjyqësorin. Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije se në këtë takim do të insistohet për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në këtë proces

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Pas një pauze të gjatë, sot (e hënë) në Bruksel do të zhvillohet takimi i radhës i dialogut teknik mes të ekipeve të Kosovës e të Serbisë. Ekipi i Kosovës i udhëhequr nga Avni Arifi dhe ai serb nga drejtori për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjurij, do të takohen sot në Bruksel për të diskutuar rreth zbatimit të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe për tabelat e regjistrimit të automjeteve, për marrëveshjen për menaxhimin e vendkalimeve kufitare si dhe për marrëveshjen për gjyqësorin.

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se në këtë takim dhe në takimet e radhës do të insistohet për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në këtë proces. Ai ka thënë se zvarritja e marrëveshjeve nga të dyja palët nuk i shërben as qëllimit të dialogut e as ndërtimit të mirëbesimit të ndërsjellë. "Mosimplementimi i marrëveshjeve apo zvarritja e tyre nga të dyja palët nuk i shërben as qëllimit të dialogut e as ndërtimit të mirëbesimit të ndërsjellë. Do t'i implementojmë të gjitha obligimet që kemi marrë, njëkohësisht do të insistojmë që obligimet e marra nga pala tjetër të implementohen në tërësi", është shprehur ai.

Arifi ka deklaruar se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ketë një dinamikë dhe qasje të re. Sipas tij, ky proces tash e tutje do të jetë më transparent dhe më gjithëpërfshirës. "Gjithsesi se do të ketë një dinamikë të re, por qëllimi dhe fokusi do të jenë tjetër. Pra, do të fokusohemi për implementimin e marrëveshjeve ekzistuese. Tema për të cilën po flasim nuk është vetëm temë e një koalicioni qeverisës të një mandati, andaj do të përpiqemi të jemi sa më gjithëpërfshirës

dhe sa më transparentë", ka theksuar Arifi.

Ai ka mohuar çdo mundësi që në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi të diskutohet për shkëmbin terriroresh. "Asnjë mekanizëm në Kosovë, shtetëror apo partiak, nuk e përkrah idenë e ndarjes. Qeveria e Kosovës çdoherë ka qenë shumë e qartë në këtë dhe

është e pakuptueshme pse përsëritet një pyetje e tillë. Kosova me askënd nuk ka as çka të ndajë e as çka të shkëmbejë territor të vet. Idetë për destabilizim permanent të rajonit kanë ekzistuar edhe më parë por, fatmirësisht, ide të tilla nuk janë përfillur", është shprehur Arifi.

Dialogu teknik në Bruksel në mes të dy delegacioneve është paraparë të vazhdojë edhe nesër (e martë). Ky raund bisedimesh është dashur të zhvillohej në muajin janar, por vrasja e Oliver Ivanoviçit bëri që ekipi serb përkohësisht të tërhiqet. Kurse dialogu në nivel të presidentëve Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq pritet të mbahet në fillim të muajit mars.

Ndërkohë partitë opozitare

kanë shprehur qëndrime të kundërta sa i përket mundësisë së përfshirjes së tyre në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përderisa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shprehur gatishmëri për ta dhënë kontributin e vet në këtë proces, nga ana tjetër Lëvizja Vetëvendosje (LV) vazhdon të insistojë se vazhdimi i dialogut është i panevojshëm, meqë Serbia ende e konsideron Kosovën pjesë të vet.

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se edhe ky proces pritet të mbyllet me një rol aktiv të kësaj partie, i cili do të qartësohet pas përfundimit të procesit të shumëpritur të liberalizimit të vizave. Megjithatë, ai ka thënë se procesi i dialogut me Serbinë shumë shpejt

duhet ta ketë një qartësi të plotë sa i përket agjendës dhe orarit. Në këtë kontekst, Haziri ka shprehur optimizëm se ky proces së shpejti do të ketë një riformatim, një rishikim të agjendës dhe një orar më të saktë me tema më të qëndrueshme lidhur me përmbylljen e këtij procesi. Kurse sekretari organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo parti do të mund të ishte pjesë e këtij procesi dhe ta udhëhiqte atë vetëm kur Serbia e pranon Kosovën. Ai ka thënë se sa i përket dialogut aktual Lëvizja Vetëvendosje jo vetëm që nuk do të marrë pjesë, por është kundër vazhdimit të tij. Sipas Kurteshit, Kosova si shtet i pavarur nuk duhet të pranojë kurrfarë nënshtrimit nga Serbia.



Lëvizja Vetëvendosje kundërshton marrëveshjen ndërmjet PDK-së, AAK-së, Nismës, AKR-së dhe LDK-së për kalimin

Beteja e demarkacionit



Koalicioni qeverisës ka siguruar votat e deputetëve të LDK-së, por jo edhe të deputetëve të Listës Serbe, që është pjesë e këtij koalicioni, për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi. Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se deputetët e saj nuk do ta votojnë demarkacionin, ndërsa tani kryeministri Haradinaj i mbetet t'i sigurojë votat e Listës Serbe. Për kalimin e kësaj marrëveshje nevojiten mbi 80 vota, derisa me pajtimin në mes të PDK-së, AAK-së, Nismës dhe LDK-së janë siguruar 78 vota

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 SHKURT - Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar arritjen e marrëveshjes për votimin e demarkacionit me Malin e Zi ndërmjet PDK-së, AAK-së, Nismës dhe LDK-së. Në këtë mënyrë kjo parti ka refuzuar ftesën e subjekteve të tjera politike shqiptare që deputetët e saj ta votojnë këtë marrëveshje, e cila do t'i hapte rrugë liberalizmit të vizave. Tani koalicioni qeverisës së bashku me LDK-në në Kuvendin e Kosovës kanë 78 vota, kurse tri votat e tjera të nevojshme për ratifikimin e demarkacionit pritet të vijnë nga Lista serbe, e cila ende nuk i ka treguar publikisht kërkesat e saj për votimin

e demarkacionit.

Lëvizja Vetëvendosje, përveçse ka mohuar mundësinë që ndonjë deputet i saj ta votojë demarkacionin, ka akuzuar kryeministrin Haradinaj për zbrapsje për këtë çështje. "Duke qenë se kryeministri i njëj mirë të gjitha argumentet kundër këtij versioni të demarkacionit dhe pavarësisht kësaj, e bën atë edhe më përgjegjës se të tjerët. Qëndrimi i tij është zbrapsje. Ai është zbrapsur me t'u bërë kryeministër dhe po tërhiqet plotësisht tash kur e ka mundësinë që t'ia shpëtojë Kosovës 8 200 hektarë, ose t'i falë ato për të mbetur thjesht kryeministër. Ne nuk e mirëkuptojmë dhe as e kuptojmë zellin e askujt që shtyn një marrëveshje të tillë për vendin.

Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta votojë këtë Projektligj të dëmshëm. Lëvizja Vetëvendosje do ta kundërshtojë atë", është thënë në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas LV-së, pajtimi që është arritur të shtunën ndërmjet partive politike shqiptare është një pazar fjalësh që Kosovës ia humbet 8 200 hektarë. "Pas fjalëve të forta në seancën e së premtes në Kuvend, kryeministri Haradinaj qenka marrë vesh me LDK-në për votimin e demarkacionit me Malin e Zi. E kanë shtuar fjalën 'si orientim' për raportin e komisionit Bulliqi, duke dashur ta krijojnë përshtypjen që edhe po e përfshijmë raportin që akuzon e rrënon komisionin Meha, edhe të mos e marrim seriozisht atë. Kështu nuk shkruhen e nuk

bëhen ligjet. Ky pazar fjalësh na i humbet 8 200 hektarë njësoj. Ky Projektligj ishte i padrejtë dhe i dëmshëm e tani bëhet edhe më i keq pas këtyre akrobacioneve. Ai është krim dhe tradhti që duhet kundërshtuar e nuk duhet legjitimuar", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

Ndërsa të gjitha subjektet e tjera politike e kanë ftuar Lëvizjen Vetëvendosje që deputetët e saj ta votojnë demarkacionin me Malin e Zi, në mënyrë që të hapet rruga për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka mirëpritur gatishmërinë e partive të koalicionit për ta pranuar propozimin e këtij subjekti politik lidhur me Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi. "Kjo e hap rrugën që sa më parë në Kuvendin e Kosovës të ratifikohet kjo marrëveshje dhe të kërkojmë nga BE-ja që qytetarët e Kosovës të lëvizin lirshëm, sikurse qytetarët e vendeve të tjera të rajonit. LDK-ja fton edhe Vetëvendosjen të bashkohet në

ratifikimin e kësaj marrëveshjeje që është në interesin e të gjithë qytetarëve të Kosovës", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka konfirmuar se nga koalicioni qeverisës është mënjëruar pengesa e fundit politike për unitet politik në Kuvend. Përmes një konference për medie, Haradinaj ka thënë se Projektligji i marrëveshjes për demarkacionin përmban marrëveshjen e gushtit 2015, deklaratën e përbashkët të dy presidentëve, Thaçi dhe Vuçanoviq, si dhe raportin e Komisionit Shtetëror për Shënimin e Kufirit me Malin e Zi. "E kam bërë një pajtim me kërkesë të LDK-së. Besoj se me këtë u kemi hapur mundësi qytetarëve të lëvizin lirshëm. Në nenin 3, pika 1.2, thotë se dokumentacioni do të përdoret si orientim. Pra, vetëm kjo është shtuar, pasi ka qenë kërkesë e LDK-së në mënyrë që të ecim përpara", ka thënë Haradinaj. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka deklaruar se nga Lista Serbe

e demarkacionit me Malin e Zi

cionit, për tri vota



ende nuk kanë ndonjë përgjigje zyrtare rreth kësaj çështje. "Na vjen keq që Vetëvendosja tashmë zyrtarisht ka deklaruar se është kundër marrëveshjes. Ne u bëjmë ftesë edhe atyre që ta ndryshojnë mendjen ose së paku të mos bëjnë presion brenda deputetëve të vet dhe t'i lënë ata të votojnë lirshëm sipas ndërgjegjes dhe bindjes së tyre", ka deklaruar Krasniqi.

Me arritjen e marrëveshjes, përfaqësuesja e posaçme e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka theksuar se ky është një hap i rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave. Ajo u ka bërë thirrje edhe Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Serbe ta mbështesin marrëveshjen e cila është marrëveshje për të gjithë në Kosovë. Vazhdimi i seancës për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi do të mbahet këtë të mërkurë, ditën kur Kosovën do ta vizitojnë disa zyrtarë të lartë të BE-së. Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se pa ratifikimin e Demarkacionit, Kosova nuk do të mund të përfshihet në zonën e lëvizjes së lirë, brenda BE-së, pa viza. Marrëveshja për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë. Si e tillë, kjo marrëveshje ishte ratifikuar nga Kuvendi i Malit të Zi, por jo edhe nga ai i Kosovës.

Thaçi: Miratimi i demarkacionit përfundimisht siguron lirinë e lëvizjes

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se marrëveshja e së shtunës mes partive politike për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi është një lajm jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhmen evropiane të Kosovës. "Uroj të gjithë përfaqësuesit e këtyre partive politike për konsensusin e arritur, i cili përfundimisht siguron lirinë e lëvizjes për qytetarët e Kosovës në Zonën Shengen. Ky unitet politik duhet të shërbejë si një kornizë afatgjatë për gjetjen e zgjidhjeve për temat nacionale, të cilat kërkojnë vullnet dhe gatishmëri për t'i tejkaluar interesat e ngushta partiake dhe private", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook". Marrëveshjen e së shtunës e kanë përhëndetur edhe lideri i Nismës, Fatmir Limaj dhe presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli.

Tahiri: Vuçiqi nuk po ofron informata mbi fatin e të zhdukurve

EPOKA E RE

Faton DERMAKU

PRISHITINË, 25 SHKURT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, po tregohet indiferent për ofrimin e informatave për të pagjeturit. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Republika e Kosovës ka hyrë në dekadën e dytë me vizion dhe shpresa të reja, por assesi duke harruar çështjet që kemi trashëguar dhe për të cilat duhet të përpiqemi më shumë se kurrë. "Ndriçimi i fatit të personave të zhdukur, si një prej çështjeve më të ndjeshme që, fatkeqësisht, mban peng edhe sot e kësaj dite shumë familje kosovare, është preokupim i vazhdueshëm imi si ministër i Drejtësisë", ka thënë



Tahiri.

Ai ka treguar se ka diskutuar me kryetarin e Komisionit për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj dhe kryetarin e Shoqatës "Zëri i Prindërve", Bajram Qerkini, për

obligimet e përbashkëta institucionale dhe hapat që duhen ndërmarrë më tutje që kjo temë të marrë një epilog sa më parë që është e mundur. "Përkushtimi dhe mbështetja ime për t'i

adresuar shqetësimet e familjeve të personave të zhdukur nuk do të rreshtë për asnjë moment. Tashmë është e qartë se adresa e vërtetë e këtij problemi është presidenti i Serbisë, Aleksandër

Vuçiq, i cili është duke treguar indiferencë dhe mosgatishmëri për t'i nxitur organet serbe të bashkëpunojnë me institucionet tona, për të ofruar informata dhe dëshmi mbi fatin e të zhdukurve", ka thënë ministri Tahiri.

Megjithatë, ai ka shtuar se kjo indiferencë për asnjë moment nuk do t'i ndalojë që të bëhen edhe më këmbëngulës dhe të pakompromis për zgjidhjen e kësaj çështje. "Në ditët në vijim do të angazhohemi së bashku me të gjitha institucionet dhe shoqatat e familjarëve për ta zgjeruar agjendën e përpjekjeve institucionale, derisa të marrin përgjigje edhe 1 652 rastet e evidentuara, në mesin e të cilave, 130 fëmijë, për të cilët duhet të ketë një adresë", ka thënë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Austriakët, shembull për të gjithë ne që flasim për bashkim e ndarje

PRISHTINË, 25 SHKURT -

Sikur kanë një histori pak të ngjashme Austria dhe Kosova, z. Petritsch, pas luftës deri kur u vendos pavarësia apo sovraniteti i vendit, apo e kam gabim?

Wolfgang Petritsch: Po, po, keni të drejtë. Ne, në Austri, në vitin 1945 kemi qenë vend totalisht i shkatërruar pas një lufte dhe pastaj me ndihmën e amerikanëve, të planit Marshall, kemi ndërtuar vendin tonë. Kjo ndoshta mund t'u shërbejë njerëzve në Kosovë si shembull. Austriakët, gjithashtu, kanë punuar shumë; atyre u janë dhënë mundësitë, por pastaj duhej ta merrnin fatin në dorën e tyre. Dhjetë vjet me radhë kemi pasur forca të huaja, Bashkimi Sovjetik, ShBA-ja, Anglia, Franca, të cilët e patën ndarë mes vete Austrinë, ngjashëm siç ka qenë rasti i Kosovës dhe ne atyre ua kemi dëshmuar, që ne mund ta bëjmë punën vet dhe pas dhjetë vjetësh, më 1955, përfundimisht vendit i janë dhënë liria dhe sovraniteti.

Por shqiptarët përsëri mbetën të ndarë dhe shpesh spekulohet kur bëhet fjalë për bashkimin e shqiptarëve. Madje sikur bëhet rrezik nëse do të kishim një

Shqipëri të madhe? A justifikohet ky panik?

Wolfgang Petritsch: I ashtuquajtur panik në rajon kur flitet për bashkimin e shqiptarëve, ose për një Shqipëri të Madhe, më duket qesharak, kur kihet parasysh se sa milionë shqiptarë jetojnë atje. Besoj se shqiptarët duhet të jetojnë në Evropë, por jo gjithë në një Shqipëri. Në ditët e sotme kjo nuk është më e domosdoshme. Kur je në Evropë, në BE, atëherë kufijtë nuk lozin rol më por, megjithatë, kjo është një fantazmë, të cilën e konsideroj të tepruar. E madhe është ndoshta Kina me 1.3 miliard banorë, India apo edhe ShBA-ja, apo në Evropë ndoshta edhe Gjermania, por një Shqipëri e madhe do të kishte ndoshta shtatë apo tetë milionë banorë. Unë do të mendoja, që të mos harxhohen energji politike për bashkimin në një shtet. Më e rëndësishme është të zhvillohen marrëdhënie të mira fqinjësore jo vetëm mes Prishtinës dhe Tiranës, por të krijohen lidhje të mira me Maqedoninë, Malin e Zi, e të shprejtojmë së shpejti edhe me Beogradin, natyrisht edhe me Sanxhakun e tutje me Bosnjën etj. Kjo më duket e mirë, e atëherë s'është e rëndë-



Mimosa Kelmendi në bisedë me diplomatin austriak Wolfgang Petritsch

sishme, nëse je në një shtet apo te një tjetër.

Po edhe ju austriakët keni qenë bashkë me gjermanët, megjithatë përsëri jeni të ndarë. Ndërkohë që ne duket sikur duam të jemi bashkë sepse na ishin të tjerë që na ndanë? Dallim i madh apo? Wolfgang Petritsch: Nuk është dallim shumë i madh. Ne aus-

trianët një herë kemi qenë në një situatë të ngjashme: Pas 1918-s çdo austriak ka menduar se "nuk mund të mbijetojmë si vend i vogël me gjashtë milionë banorë. Ne duhet t'i bashkëngjitemi Gjermanisë". Kjo pastaj ka ndodhur dhe të gjithë pas 1945-s kanë thënë: kurrë më, ne duam të mbetemi të vetëm. Por, megjithatë, kemi marrëdhënie shumë të mira

politike, ekonomike e kulturore me Gjermaninë. Është me rëndësi që të thuhet, se askush nuk duhet të ketë frikë nga një Shqipëri e madhe, as shqiptarët e Kosovës, apo shqiptarët që jetojnë në Maqedoni. Sot në shekullin 21 shteti ynë i përbashkët është Evropa.

(Marrë nga libri "Kosova si çështje evropiane" të autores Mimosa Kelmendi)

Kryetar i SBASHK-ut rizgjedhet Rrahman Jasharaj

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Delegatët e Kongresit të VII të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës (SBASHK) e kanë rizgjedhur Rrahman Jasharajn kryetar edhe për një mandat në krye të kësaj organizate. Sipas një njoftimi dërguar medieve, delegatet e Kongresit të VII të SBASHK-ut kanë vlerësuar punën dhe angazhimet e kryetarit aktual Jasharaj. "Për këtë punë të mirë që ka bërë gjatë mandatit të parë në shërbim të anëtarësisë, e shpërblyem me votën e delegatëve edhe për një mandat të dytë", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

I pari që e uroi rizgjedhjen e Jasharajt ishte kundërkandidati i tij, Alush Maloku.

Po ashtu, delegatët kanë zgjedhur edhe Komisionin

Mbikëqyrës, Komisionin Statutar dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut. Delegatët kanë bërë plotësim/ndryshimin e Statutit dhe kanë nxjerrë pesë rezoluta: Rezolutën për të ardhmen e profesionit të mësimdhënies; Rezolutën për pensionimin e parakohshëm dhe për pensione dinjitoze të punëtorëve të sëmurë rëndë; Rezolutën mbi dokumentin e politikave të arsimit "Ndërtimi i së ardhmes përmes edukimit cilësor"; Vendosja e prioriteteve për ta zhvilluar planin e veprimtari për barazi, shumëllojshmëri dhe gjithëpërfshirje; dhe Rezolutën për veprimet e filluara sindikale. Në përfundimet e Kongresit të VII të SBASHK-ut, kryetari i rizgjedhur, Jasharaj, ka premtuar se do t'i vazhdojë angazhimet në të mirë të këtij institucioni.



Thaçi ua dhuron prindërve librin e shkruar për të

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u ka bërë dhuratë prindërve të vet, librin e shkrimtarëve anglezë të shkruar për biografinë e presidentit aktual dhe ish-udhëheqësit politik të

Ushtisë Çlirimtare të Kosovës. "Pata kënaqësinë t'ua përcjell një dhuratë prindërve nga gazetarët anglezë të biografisë sime. Edhe nëna dhe babai u intervistuan gjerësisht për këtë libër nga autorët. Ata nuk

kanë pasur mundësinë ta mësojnë anglishten, por sot patëm arsye t'i rikujtojmë momentet e gëzimit dhe pikëllimit të familjes sonë, të shprehura në fjalë dhe fotografi në këtë libër", ka shkruar presidenti Thaçi në

llogarinë e vet në "Facebook". Libri për jetën dhe veprimtarinë e Thaçit është shkruar nga Suzy Jagger dhe Roger Boyes. Libri quhet "New State, Modern Statesman: Hashim Thaçi - A Biography".



Mbi pesë mijë qytetarë në vit heqin dorë nga shtetësia e Kosovës

Zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë bërë me dije se mbi dyzet mijë shtetas të Republikës së Kosovës kanë hequr dorë nga shtetësia që nga viti 2009 e këndej. Në vitin 2014 nga nënshtetësia e Kosovës kanë hequr dorë 5 158 persona, kurse në vitin 2016 ky numër ka shënuar rritje në 5 871 persona

PRISHTINË, 25 SHKURT - Sipas të dhënave të katër vjetëve të fundit, mesatarisht në vit nga nënshtetësia e Kosovës janë liruar më shumë se 5 000 mijë qytetarë. Trendi i lirimt nga nënshtetësia ka shënuar ngritje nga viti 2014. Në vitin 2014 nga nënshtetësia e Kosovës kanë hequr dorë 5 158 persona, kurse në vitin 2016 ky numër ka shënuar rritje në 5 871 persona. Rroksana Qarri, drejtoreshë e Zyrës për Komunikim Publik, thotë se numri më i madh i atyre që kanë humbur shtetësinë e Republikës së Kosovës vjen nga shtetasit e Kosovës që jetojnë në Gjermani. "Arsyet kryesore të heqjes dorë nga shtetësia janë marrja e shtetësisë së ndonjë vendi tjetër të Bashkimit Evropian, i cili nuk lejon dyshtetësinë për shtetas që nuk janë shtetas të Bashkimit Evropian. Pra, siç mund ta shihni, bëhet fjalë për shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët jetojnë në shtete të ndryshme të Bashkimit Evropian që një kohë të gjatë jetojnë në atë vend dhe i plotësojnë kushtet ligjore për ta marrë shtetësinë e atij vendi", ka thënë Qarri. Përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë konsiderojnë se një nga arsyet e lirimt të qytetarëve nga nënshtetësia e

Kosovës dhe marrja e shtetësisë së një shteti tjetër, përveç të tjerash, është edhe ngecja që ka shënuar vendi në zhvillimin e gjithëmbarshtëm, në veçanti atë ekonomik.

Isuf Zejna nga organizata "Demokracia Plus", në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se lirimt i qytetarëve të Kosovës nga nënshtetësia dhe marrja e nënshtetësisë së një vendi tjetër, nuk është një gjë e mirë që po i ndodh shtetit. "Kjo vjen si rezultat i emigracionit të madh që e kemi në Kosovë për shkak të mosperspektivës ekonomike, qytetarët tanë kërkojnë vazhdimisht të gjejnë punë dhe të dislokohen nga vendi i tyre i lindjes dhe të kërkojnë mirëqenie në shtetet e Evropës perëndimore. Një numër i këtyre shteteve, siç është rasti i Gjermanisë, nuk u japin nënshtetësi qytetarëve të Kosovës pa hequr dorë nga nënshtetësia e Kosovës. Si rezultat i kësaj, qytetarët detyrohen të heqin dorë nga nënshtetësia e Kosovës", ka thënë Zejna. Ai ka shtuar ka thënë se fajtor për gjithë këtë është shoqëria, në përgjithësi e Kosovës, e cila, siç thotë ai, ka dështuar për krijimin e një ekonomie të zhvilluar, e cila siguron mirëqenie më të mirë për qytetarët.



Ai ka thënë se numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të botës, e të cilët do të heqin dorë nga nënshtetësia e vendit të tyre, mund të rritet në të ardhmen, për shkak se mundësitë që ua ofrojnë shtetet ku ata jetojnë, janë shumë më të mëdha sesa çfarë u ofron Kosova. "Ekonomitë e mëdha mund t'u ofrojnë kushte më të mira këtyre njerëzve sesa Kosova. Sot mund të jeni kirurgu më i mirë në Kosovë, po nuk ke perspektivë shumë të madhe, pagat janë të ulëta, nuk ka për-

fitime, në anën tjetër shtetet e Evropës perëndimore ofrojnë dhjetëfishin e pagës që e marrin (kirurgët) në Kosovë dhe përfitime tjera që Kosova, fatkeqësisht, është jo konkurrenente t'i bëjë ballë këtij trendi të shpërnguljes së njerëzve, në veçanti atyre të kualifikuar", ka sqaruar Zejna.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Diasporës, në Qeverinë e Kosovës janë rreth 400 mijë qytetarë që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës. Këto janë rezultate të regjistrimit të diasporës në

kuadër të projektit "Ti je pjesë e atdheut", të publikuar në vitin e kaluar. Sipas këtyre rezultateve, numri më i madh i qytetarëve të Kosovës jetojnë në Gjermani, Zvicër, pastaj në Itali, Suedi dhe Kanada.

Numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të botës konsiderohet të jetë edhe më i madh. Të dhënat përfundimtare të regjistrimit të diasporës pritet të publikohen në vitin 2021, pasi të përfundojë edhe regjistrimi elektronik, i cili vazhdon të jetë aktiv.

Thaçi: Kosova do të jetë anëtare e OKB-së



PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një intervistë për televizion publik të Japonisë "NHK" dhe gazetën më të madhe "Mainichi", ka folur për dhjetëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në këto dy intervista presidenti Thaçi ka folur për shtetndërtimin, zhvillimin ekonomik, aspiratën për t'u bërë vend anëtar i NATO-s dhe BE-së.

Presidenti Thaçi, për dy mediumet më të rëndësishme në Japoni, ka folur edhe për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi për të përditshmen japoneze "Mainichi" ka theksuar se në këta dhjetë vjet Kosova ka arritur të sigurojë shumë njohje dhe anëtarësim në shumë organizata ndërkombëtare. "Në këta dhjetë vjet kanë ndodhur ndryshime historike", ka shtuar ai. Thaçi, për mediat japoneze, ka thënë se Kosova në dekadën e pavarësisë ka arritur të ketë katër

për qind të rritjes ekonomike. Sipas tij, është arritur të përmirësohet rritja e të punësuarve si dhe rritja e mirëqenies sociale.

Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova aspiron që sa më shpejt të bëhet anëtare e BE-së dhe NATO-s. Duke folur për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Thaçi për televizion publik të Japonisë "NHK" ka thënë se beson se gjatë këtij viti do të arrihet një marrëveshje historike ndërmjet dy shteteve. "Por, do të ndërtojmë, do ta arrijmë marrëveshjen historike, si dy vende sovraane, për paqe, stabilitet, normalitet dhe pajtim e bashkëpunim", ka shtuar Thaçi për "NHK".

Ndërsa për gazetën e përditshme "Mainichi", presidenti Thaçi ka thënë se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë do t'i mundësojë Kosovës anëtarësim në Kombet e Bashkuara.

Flet për "Epokën e re" këshilltari i kryeministrit të Shqipërisë, Lulzim Rafuna

Dogana Shqipëri - Kosovo

- Nga muaji mars Shqipëria dhe Kosova do të kenë një pikë të përbashkët doganore Morinë - Vermicë

- Shqipëria i ka bërë përgatitjet për t'ia dorëzuar në shfrytëzim Qeverisë së Kosovës zyrën e Doganës në Durrës

Lulzim Rafuna, këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë për dogana dhe tatime, ka thënë se bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ka avancuar shumë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ish-drejtori i Doganës së Kosovës ka bërë me dije se në muajin e ardhshëm do të ketë lehtësira doganore ndërmjet dy vendeve. Sipas Rafunës, tani do të jetë një pikë e përbashkët doganore Kosovë - Shqipëri në kufirin Morinë - Vermicë. "Këtu do të kemi ndryshimin më të madh në muajin e ardhshëm, ku do t'i vendosim të dy doganat në një dritare të vetme", ka thënë Rafuna, duke bërë me dije se të dy qeveritë janë duke ndërmarrë veprime për t'i eliminuar burokracitë institucionale

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Lulzim Rafuna, këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë për dogana

dhe tatime, ka thënë se bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ka avancuar shumë. Ai ka thënë se çdo ditë e më shumë bizneset e Kosovës dhe të Shqipërisë janë

duke e shtrirë bashkëpunimin mes vete. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rafuna ka theksuar se kryeministri Rama është duke marrë hapa konkretë për thjeshtëzimin e procedurave dhe eliminimin në minimum të mundshëm të burokracisë me letra, "me të vetmin qëllim që kufiri i Shqipërisë me Kosovën të jetë sa më pak i dukshëm sesa si administratë klasike".

Ish-drejtori i Doganës së Kosovës ka bërë me dije se në muajin e ardhshëm do të ketë lehtësira doganore ndërmjet dy vendeve. Sipas Rafunës, do të jetë një pikë e përbashkët doganore Kosovë - Shqipëri në kufirin Morinë - Vermicë. "Këtu do ta kemi ndryshimin më të madh në muajin e ardhshëm, në mars, ku do t'i vendosim të dy doganat në një dritare të vetme", ka thënë Rafuna. Ai ka pohuar se bashkëpunimi doganor ndërmjet dy vendeve ka avancuar shumë, sidomos që nga viti 2014 e tutje.

"Epoka e re": Z. Rafunaju tani më shumë se një vit jeni pjesë e kabinetit të këshilltarëve të kryeministrit shqiptar, Edi Rama. Si erdh deri te ky vendim?

Rafuna: Pas përfundimit të mandatit tim në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, kryeministri Edi Rama ma ofroi pozitën e këshilltarit special për dogana dhe tatime. Kjo për mua ishte nder shumë i madh së pari t'i shërbej një kryeministri të Shqipërisë siç është Edi Rama dhe, e dyta, më ofrohet një pozitë e tillë e cila vjen si rezultat i punës së bërë gjatë mandatit tim në reformën e Doganës së Kosovës.



"Epoka e re": A mund ta konsiderojmë këtë si përafrim të dy shteteve sa i përket bashkëpunimit edhe të kuadrove dhe proceseve të tjera që kanë këto dy vende?

Rafuna: Pa dyshim se po. Është hera e parë në Qeveri të Republikës së Shqipërisë që angazhohet një këshilltar nga Kosova si pjesë e stafit të rregullt të kryeministrit Rama (jo me projekte të huaja), që e zgjedh vetë kryeministri. Ky është një hap shumë i madh në avancim të marrëdhënieve tona në çdo aspekt. Është një vendim i cili nuk ka ndodhur asnjëherë më parë në të kaluarën. Në anën tjetër, kjo tregon se sa të rëndësishme e ka çështjen e Kosovës në agjendën e vet kryeministri Rama, për avancim jo vetëm të marrëdhënieve tona të dy shteteve, por edhe më lart në fusha të tjera për ta mbështetur Kosovën në avancimin e saj.

"Epoka e re": Si e vlerësoni bashkëpunimin ekonomik Kosovë - Shqipëri?

Rafuna: Bashkëpunimi ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë ka avancuar shumë dhe për këtë jam shumë i lumtur, sidomos tani që kam mundësi të shoh në dy shtetet një avancim shumë të madh në çdo aspekt. Çdo ditë e më shumë bizneset e Kosovës dhe të Shqipërisë po e shtrijnë bashkëpunimin mes vete. Kjo është për t'u vlerësuar. Se as është i mjaftueshëm ky bashkëpunim, pa dyshim se jo, sepse ka ende shumë hapësirë për bashkëpunim për lehtësimin e shumë temave. Kryeministri Rama është duke marrë hapa konkretë për thjeshtëzimin e procedurave dhe eliminimin e burokracisë me letra, me të vetmin qëllim që kufiri i Shqipërisë me Kosovën të jetë sa më pak i dukshëm sesa si administratë klasike. Këtu do ta kemi



vë, një dritare e vetme



ndryshimin më të madh në muajin e ardhshëm, në mars, kur do t'i vendosim dy doganat në një dritare të vetme. Çdo biznes vetëm do të evidentohet në vendkalimin doganor të Morinës. Vuajtjet e biznesit nga procedurat doganore klasike do të marrin fund gradualisht në muajt e ardhshëm. Çdo ministër në Qeverinë e Shqipërisë e ka të qartë vizionin e kryeministrit Rama karshi shtetit të Kosovës. Të gjithë ministrat e Shqipërisë e trajtojnë Kosovën me prioritetin më të lartë në kuadër të punës së tyre ditore, si brenda shtetit, po

ashtu edhe jashtë shtetit, në çdo takim me homologët e tyre apo edhe në konferenca të ndryshme ndërkombëtare.

"Epoka e re": Sa ka avancuar bashkëpunimi doganor ndërmjet dy shteteve?

Rafuna: Bashkëpunimi doganor ka avancuar shumë, sidomos që nga viti 2014 e tutje. Mund të them lirshëm se vetëm administrativisht jemi dy administrata doganore të dy shteteve por, në fakt, veprojmë si një trup në operativë. Bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm prej fazës së

bashkëpunimit në shkëmbim të të dhënave në kohë reale deri te trajnimi i stafit të përbashkët. Nuk ka asnjë pengesë në bashkëpunim të dy administratave.

"Epoka e re": Mbetet evident bashkëpunimi tregtar Kosovë - Serbi, më shumë se me shtetin amë. Pse po ndodh kjo, dhe cilat aspekte duhen përmirësuar?

Rafuna: Në këtë rast duhet ta kemi parasysh se ndikojnë disa faktorë. E para, lidhjet e vjetra tregtare, e kam fjalën që nga vitet e '80-ta. E dyta, po ashtu dihet se

kompanitë e huaja kanë themeluar apo në forma të tjera janë vendosur dhe prodhojnë në Serbi. Pra, ato kompani i detyrojnë blerësit e tyre kosovarë të blejnë të njëjtin produkt të huaj, por që tani prodhohet në Serbi që, në fakt, për ne në Kosovë, reflekton eksport nga Serbia. E mira është se bizneset po shtrijnë bashkëpunimin edhe me Shqipërinë dhe kjo shihet nga statistikave zyrtare të institucioneve të dy shteteve për më shumë. Shumë produkte të cilat në të kaluarën, sidomos ato bujqësore, janë importuar nga Maqedonia dhe Serbia, janë zhvendosur dhe po importohen nga Shqipëria. Ne kemi një klimë ideale që mund të kombinohej gjatë tërë stinës në mes të dy vendeve tona. Dy qeveritë kanë ndërmarrë hapa dhe, po ashtu, janë duke ndërmarrë veprime çdo ditë e më shumë për ta eliminuar burokracinë institucionale. Komuniteti i biznesit ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm mes tyre. Po ritheksoj se ende ka hapësirë për avancim të marrëdhënieve tona. E kisha këshilluar komunitetin e biznesit që të ushtrojë pa reshtur kërkesa tek të dyja qeveritë për t'i ndihmuar në të bërit biznes. Tani është fat që në Qeverinë e Kosovës kemi ministër të Financave z. Hamza dhe në Qeverinë e Shqipërisë z. Ahmetaj, të cilët kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Veçse e kanë filluar bashkërendimin e veprimeve që duhet të merren nga dy qeveritë për integrim më të madh dhe të shpejtë të dy ekonomive tona. Nuk duhet harruar se për dy shtetet tona sa më shpejt që ekonomikisht integrohemi dhe harmonizohemi me politika, do të jetë më e dobishme për zhvillim më të fuqishëm ekonomik të dy shteteve tona. Është shumë mirë që po ndodh integrimi më i shpejtë ekonomik Kosovë - Shqipëri sesa me rajonin. Një treg i harmonizuar me një numër të kësaj popullate që kemi të dy shteteve na bënë shumë më atraktivë në aspektin e investimeve dhe konkurrencës me cilindo treg të çdo shteti të rajonit. Të dy ministrat janë duke bërë hartimin e akteve të për-

bashkëta që tregojnë një rrugë integruese, harmonizuese të politikave të përbashkëta të tregut për zhvillim më të fuqishëm ekonomik të të dyja shteteve.

"Epoka e re": Sipas të dhënave në dispozicion në vitin 2017, Shqipëria eksporton në Kosovë mallra në vlerë rreth 150 milionë euro, ndërsa Kosova eksporton në Shqipëri rreth 35 milionë euro. Pse janë më të pranishme produktet e Shqipërisë në Kosovë?

Rafuna: Tani është zhvendosur kërkesa nga shtetet fqinje të tjera të Kosovës në Shqipëri, por edhe interesimi i eksportuesve të Shqipërisë është shtuar për të eksportuar në Kosovë. Kjo lidhje, përkatësisht bashkëpunimi, ndihmon që edhe produktet tona të eksportohen në Shqipëri dhe të gjitha këto subjekte së bashku ta shtrijnë bashkëpunimin për të eksportuar së bashku edhe jashtë Shqipërisë.

"Epoka e re": Në sezonin e verës zakonisht eksportuesit nga Kosova po përballen me barriera për në Shqipëri. Për shembull, kishim rastin e patate dhe të rrushit.

Rafuna: Fatqeqësisht, kjo ka ndodhur. Fatmirësisht, i takon së kaluarës.

"Epoka e re": Pritet që këtë verë të mos përsëriten këto probleme?

Rafuna: Nëse ndodh një gjë e tillë, do të nxirret publikisht arsyeja pse po ndodh një gjë e tillë.

"Epoka e re": Në fund, a mund të flasim për vetëm një pikë të përbashkët doganore Kosovë - Shqipëri?

Rafuna: Po do të ndodhë. Në muajin mars, në kufirin Morinë dhe Vermicë. Shqipëria i ka bërë të gjitha përgatitjet për t'ia dorëzuar në shfrytëzim Qeverisë së Kosovës, pas një kohe të gjatë, zyrën e operimit të Doganës së Kosovës në Durrës. Pas përfundimit të procedurave në Qeveri të Kosovës, mbetet të vendoset se kur do ta marrë në shfrytëzim zyrën doganore.

Haradinaj në Samitin e Londrës prezanton mbi 30 projekte

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka udhëtuar të dielën për në Britani të Madhe, ku do të

marrë pjesë në Samitin e Londrës, organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Kryeministri Haradinaj në këtë

Samit do të prezantojë mbi 30 projekte nga komuna të ndryshme të Kosovës, por edhe projekte rajonale në vlerë rreth 600 milionë euro. Përveç kësaj,

kryeministri Haradinaj do të zhvillojë takime bilaterale me përfaqësues të lartë britanikë, për të cilat opinioni do të njoftohet me kohë.



Reshitaj, kryetarëve të komunave: Projektet kapitale nuk janë menaxhuar si duhet

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, ka porositur kryetarët e komunave të jenë më të vëmendshëm në projektet kapitale. Ajo ka thënë se ka pasur investime në shumë projekte kapitale, por ato nuk janë menaxhuar si duhet nga institucionet përgjegjëse

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, ka marrë pjesë në konferencën me kryetarët të komunave të Republikës së Kosovës, të organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me mbështetjen e misionit të OSBE-së në Kosovë. Gjatë kësaj konference ministria Reshitaj ka folur për shumë çështje të mjedisit dhe planifikimit hapësinor, për të cilat komunat duhet të angazhohen më shumë. "Kosova ka ligje dhe akte nënligjore konform direktivave të Bashkimit Evropian, por zbatimi i tyre nuk është në nivelin e duhur. Kemi investuar

në shumë projekte kapitale të cilat nuk janë menaxhuar si duhet nga institucionet përgjegjëse, andaj kërkoj nga ju që bashkërisht t'i shtyjme proceset përpara", është shprehur Reshitaj.

Ministria Reshitaj ka pasur një porosi edhe për kryetarët e komunave me shumicë serbe, duke thënë se mjedisi është i përbashkët dhe i tillë duhet të trajtohet nga të gjitha komunitetet, andaj ka kërkuar që të gjithë t'u bashkohen iniciativave për pastrimin dhe gjelbërimin e shtetit. "Më vjen keq për ata fëmijë që tani janë bërë burra e gra, që kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë jetë të izoluar, me dhjetëra gjenerata që nuk kanë çfarë të kujtojnë nga fëmijëria e tyre pos urrejtjes,



izolimit, mosqasjes në liri e integrim shoqëror. Ju lus të ndalojmë së mbjelli urrejtje tek fëmijët tanë. Ne jemi ata që më së miri i dimë pasojat, sepse i

kemi bartur vetë mbi supet tona. Jemi ne ata që mund dhe duhet ta fillojmë kthesën e proceseve në drejtim të duhur, andaj ju ftoj të gjithëve që

bashkë të punojmë për ndërtimin, zhvillimin dhe integrimin e shtetit tonë në mekanizmat ndërkombëtarë", ka deklaruar ministria Reshitaj.



20 të rinj i bashkohen PDK-së në Pejë

PEJË, 25 SHKURT (ER) - Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Pejë i janë bashkuar 20 të rinj të profileve të ndryshme arsimore. Anëtarët e rinj të PDK-së janë pritur nga kryetari i kësaj dege, Xhavit Haliti, i cili u ka

dëshiruar mirëseardhje. Haliti i ka siguruar të rinjtë se do ta kenë hapësirën dhe mbështetjen e nevojshme në PDK. "PDK-ja po vlerësohet nga të rinjtë si subjekt serioz, shtetndërtues dhe prosperues për të ardhmen

e vendit. PDK-ja si në të kaluarën edhe sot vazhdon t'u japë mbështetje të rinjve, duke vlerësuar se rinia është e ardhmja e Kosovës", ka thënë Haliti. Ai ka shtuar se rinia do të ecë përpara brenda strukturave të PDK-së.



Ftohtë e borë deri të premtën

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Sipas parashikimit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), mbi vendin tonë gjatë tërë javës do të mbajë mot i ftohtë dhe me reshje bore. IHMK-ja ka njoftuar se fushat me presion të ulët atmosferik, të cilat kanë ardhur nga viset polare, do të jenë të qëndrueshme deri ditën e enjte, duke mbajtur këtë situatë meteorologjike me mot kryesisht të vranët dhe me reshje të borës. Temperaturat minimale do të

lëvizin nga -7 deri -9 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet -3 deri 0 gradë celsius. Të enjten temperaturat mund të regjistrojnë vlera negative nën -10 gradë celsius, por që këto vlera mund të arrijnë vetëm në orët e hershme të ditës. Nga dita e premtë e tutje mercuri në termometër do të kalojë mbi vlerat e zeros, duke vazhduar rritje dita-ditës. Do të fryjë erë nga verilindja dhe juglindja me shpejtësi mbi 9m/s.

OMF-ja në lagjen "Kodra e Minatorëve" furnizohet me barna

MITROVICË, 25 SHKURT (ER) - Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen "Kodra e Minatorëve" në veri është furnizuar me barna. Kjo ndihmë për OMF-në në lagjen "Kodra e Minatorëve" ka ardhur pas premtimit që kishte dhënë një javë më parë drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës Jugore, Erseka

Hasanaj-Barani, e cila, nën shoqërimin e dr. Vllaznim Hotit dhe kryeinfermieres Rukije Hajdari-Pllana, kishte vizituar këtë qendër spitalore. Drejtoresha Hasanaj ka thënë se është e kënaqur që arriti shumë shpejt ta mbajë fjalën e dhënë. "Do të mundohem që sa më parë t'u ofroj edhe shërbime të tjera qytetarëve të kësaj zone, duke mos i lënë

asnjëherë të ndihen të anashkaluar nga Komuna e Mitrovicës Jugore", ka thënë Hasanaj. Po ashtu, ajo është zotuar se në bazë të kërkesave të stafit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në "Kodër të Minatorëve", përveç këtij premtimi, me ndihmën e kryetarit Agim Bahtiri do t'i realizojë edhe premtimet e tjera të dhëna.



"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (13)

ADEM DEMAÇI, MILITANT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT



Selatin NOVOSELLA

274. Vera Pelaj, gazetare: Romani i Adem Demaçit "Dashuria kuantike e filanit" komunikim modern në letërsi Romani i fundit të shkrimtarit të njohur Adem Demaçi "Dashuria kuantike e Filanit", është shkruar në bazën e komunikimit modern, por ngjarja zhvillohet në retrospektivë, e gërshetuar me të tashmen.

275. Vladimir Sheks, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kroacisë: Adem Demaçi të fascinojnë me besnikërinë e tij patundshme ndaj idealeve të tij Njeriu mund edhe të mos pajtohet me idetë e Adem Demaçit, por, megjithatë, të fascinojnë besnikëria e tij e patundshme ndaj idealeve për të cilat e ka sakrifikuar jetën e vet. Pse një njeri dhe intelektual të tillë ta trajtojnë e ta radhisin me kriminelët më të zinj?!

276. Vullnet Ahmeti, rektor i Universitetit të Tetovës: Adem Demaçi, figura më markante e kombit shqiptar Nderi i Kombit, Adem Demaçi, është një ndër figurat më markante të kombit shqiptar, por edhe në arenën ndërkombëtare. Ai personifikon simbolin e qëndresës së shqiptarëve në ish-Jugosllavi, kundër politikës diskriminuese dhe gjenocidale.

277. Xun Çeta, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, figura më markante e kombit Fjala e fundit për Adem Demaçin do të jepet nga studiues të kohës së ardhme që do të jenë më të liruar nga trysnia e kohës së sotme. Dhe jam i sigurt se Adem Demaçi, përfundimisht, do të mbetet figura më markante e kombit për të mësuar se si rezistohet për jetë a vdekje.

278. Xhakson, deputet anglez: Është privilegj i madh të takohesh me zotin Ddem Demaçi Është një privilegj i madh të takohesh me zotin Adem Demaçi, edhe pse është më i ri se unë. Demaçi rininë e humbi burgjeve për deri sa unë përfundova universitetin.

279. Xhavit Haliti, deputet i Kuvendit të Kosovës: Adem Demaçi, idol që shndriti rrugën e lirisë

Bacë Adem Demaçi, Ramadan Shala dhe veprimtarë të tjerë

kanë qenë për gjeneratën tonë idole që shndritën rrugën tonë drejtë lirisë.

280. Xhafer Mahmutxhiku, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Nga Burgu i Pozharevcit e kam qitur dramën e Adem Demaçit "Politika dhe Pushka"

Me rastin e lirim tim nga burgu i Pozharevcit, në Serbi, e kam qitur dramën e Adem Demaçit "Politika dhe Pushka" të fshehur në mes të dy fundeve të arkës sime që e kisha në burg.

281. Xhafer Shatri, ministër për Informim në Qeverinë e Kosovës në Ekzil: Adem Demaçi i sakrifikoi të gjitha, duke përfshirë edhe dhuntinë krijuese

Krahas tundimeve të natyrshme të Adem Demaçit që të zgjedhë në mes fatit të shkrimtarit të madh dhe kalvarit të luftëtarit të paepur për liri, krahas sakrificave të panumërta të gati tri dekadave dergjesh nëpër burgjet dhe qelitë e pushtesit të shqiptarëve, nuk duhet haruar kurrë sakrificat e shkrimtarit të talentuar që për popullin, për Kosovën e për lirinë nuk sakrifikoi vetëm rininë, familjen, jetën e tij, por edhe diçka që për autorin është akoma më e shenjtë, dhuntinë krijuese dhe dëshirën e flaktë për të shkruar.

282. Xhemajl Mustafa, veprimtar i shquar i Lidhjes Demokratike të Kosovës: Adem Demaçi, simbol i ngadhënjimit fizik dhe intelektual i një rezistence politike

Nga perspektiva e thellë e plagëve të Kosovës nuk mund të flas kurrë e kush më mirë e më bindshëm, më drejtpërdrejtë dhe më me shpirt, se sa Adem Demaçi.

Ai ishte dhe mbeti simbol i një rezistence të provuar gjatë dhe i ngadhënjimit fizik, intelektual, moral e politik të kësaj rezistence dhe të burgjeve serbo-jugosllave.

283. Xhevat Hasani, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi e vlerësonte mërgatën shqiptare si pasuri kombëtare Për vet faktin se Adem Demaçi mërgatën shqiptare, disa milionëshe, nëpër botë e ka konsideruar një pasuri të madhe njerëzore, ekonomike, politike, kulturore dhe, sipas nevojës, edhe ushtarake, ai, më shumë se cilado figurë tjetër politike e kohës e ka vizituar këtë mërgatë.

284. Xhevat Mustafa, mjek: Adem Demaçi premton pak por bënë shumë

Adem Demaçi për 28 vjet luftoi dhe qëndroi për një liri që do ta gëzojmë të gjithë ne. Ai bënë dritë për të tjerët, duke u djegur vetë. Ai premton pak, por bënë

shumë. Ai na meson se lirinë dhe jetën duhet pushtuar çdo ditë.

285. Xhevë Lladrovci, ushtar e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi, yll që ndriçon çdo skutë të Atdheut

Sapo e mbarova një kartolinë për t'ia dërguar Bacës Adem Demaçi për ditëlindje, kur dëgjuaam lajmin u liria nga burgu! Një gëzim i madh përshkoi zemrat tona. E paramendonim si yll që vjen të ndritë çdo skaje të Atdheut, të zhdukë errësirën shumëshekullore që ka kaplur popullin tonë.

286. Xhuliano Bregasi: Adem Demaçi u liria nga burgu kur po shpërbëhej Jugosllavia

Adem Demaçi, shkrimtari, intelektual dhe veprimtari i shquar politik nga Kosova, u

Adem Demaçi, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës ka thënë se "Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka në kohët më të vështira morën përsipër t'i bashkonin shqiptarët. Ata u bënë dritë që gjithë shqiptarët ta vazhdojnë kundërshtimin e tyre ndaj robërisë".

289. Zekirja Shabani, gazetar: Lëvizja Vetëvendosje refuzoi ta mbështeste propozimin që Adem Demaçi të zgjidhej president i Kosovës

Partia Demokratike e Kosovës kishte përkrahur idenë që Adem Demaçi të zgjidhej President i Republikës së Kosovës në kohën kur Behgjet Pacolli u detyrua të lëshojë këtë post. Por, Lëvizja Vetëvendosje refuzoi ta mbështeste atë. Adem Demaçi, në një prononcim për gazetën Express,

shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi, frymëzues i brezit të '68-s

Brezi i '68-s, që nga mësimet e Brezit paraardhës të Adem Demaçit, i përgatiti me guxim dhe i realizoi me shumë sukses demonstratat e mëdha të vitit 1968: për barazi, për kushtetutë, për republikë dhe për vetëvendosje të shqiptarëve nën robërinë e federatës jugosllave.

293. Willi Kuipers, senator belg: Adem Demaçi, militant për mbrojtjen e të drejtave të njeriut Adem Demaçi është shkrimtar nga Kosova dhe militant për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. I ka kaluar 28 vite të jetës së tij në burgjet jugosllave, për shkak të veprave të tij dhe kryesisht mbi respektin e lirisë dhe afrimin e popujve drejt paqes. Paralamenti Evropian e ka shpërblye me Çmimin Saharov për vitin 1991.

Gazeta dhe revista të përzgjedhura për Adem Demaçin

1. Gazeta "Zëri i Kosovës" (Nr. 10, tetor 1987): Adem Demaçi, biri i shtrenjtë i popullit tonë Këtë vit u mbushën 25 vjet që mbahet pa të drejtë në burgjet jugosllave biri i shtrenjtë i popullit tonë, simboli i rezistencës kombëtare, ideologu dhe udhëheqësi i shquar lëvizjes patriotike e revolucionare të Kosovës dhe shkrimtari i talentuar - Adem Demaçi.

2. Gazeta "Borba" (24 mars 1989) - Adem Demaçi: "Burgjet e mia janë në funksion të lirisë"

Në intervistën e Adem Demaçit dhënë gazetës beogradase "Borba", më 24 mars 1989, nga burgu, përveç tjerash, thotë: "Liria nuk mund të vritet. Burgu im është në funksion të lirisë. Jugosllavia për mua është njerka ime. Ajo, duke më mbajtur kaq gjatë në burg, ajo i ka ngritur vetit përmendoren e zezë. Asnjë masë terrori nuk mund ta ndalë luftën e popullit shqiptar për Republikën e Kosovës".

3. Gazeta "Mlladina" (26 maj 1989) - Adem Demaçi: "Dy milionë shqiptarëve iu takon Republika e Kosovës"

Nga Burgu i Stara Gradishtës Adem Demaçi, me stazhin më të gjatë të burgut në Jugosllavi, në intervistën për revistën slovene "Mlladina" tha: "Të gjithë popujt e Jugosllavisë duhet të jenë të barabartë. Që të jemi ne shqiptarët me të vërtetë të barabartë, na nevojitet Republika e Kosovës. Përse kërkesa për Republikë të jetë kundërrevolucionare?!" (Vijon)



liria nga burgu politik 28-vjeçar në vitin 1990, në një kohë kur shpërbërja e ish- Jugosllavisë Socialiste Federative të Jugosllavisë ishte në prag dhe situata për shqiptarët aty, veçanërisht në Kosovë, ishte duke u bërë gjithnjë e më dramatike.

287. Ymer Fazliu, gazetar: Përurohet Trilogjia kushtuar Adem Demaçit

Në qendrën e Kulturës "Mensur Zyberaj", në Rahovec, u bë përurimi i Tilogjisë kushtuar Heroit të Kosovës, Adem Demaçit, të autorit Selatin Novosella: "Damaçi - Lëvizja për bashkim", "Demaçi - Procesi i Prishtinës" dhe "Demaçi - Metaforë Lirie". Për librat folën Mr.Besa Hoxha - Beqiri, Dr. Sabahajdin Cena dhe Qemajl Krasniqi.

288. Zanë Zyba, gazetare: Adem Demaçi i vlerëson lartë vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën

thotë se partia e Albin Kuriti humbi një shans të mirë.

290. Zeqir Gërvalla, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi e çmonte së tepërmi Fazli Greiçevcin

Deri sa po më fliste Baca Adem Demaçi për Fazli Greiçevcin, në vitin 1963, tha: "Zeqë, Fazliu është i vrullshëm kur duhet të jetë i tillë. Është fjalëpakë e vizionar. I sinqertë, tepër i sinqertë. Ia kam lakmi sa i fjalës dhe i besës është. Është guximtar mbi të gjitha".

291. Zonja Lenz, deputete gjermane: Shpreh kënaqësinë time z. Demaçi që ju nga Çmimi Saharov

Shpreh kënaqësinë që Çmimi Saharov ju nda juve z. Demaçi, njeriut që lufton për të drejtat e njeriut. Ka një vit që me kolegen time zonjën Doris Pak isha në Kosovë, ku gjendja ishte shumë e keqe.

292. Zymer Neziri, punëtor

Kina propozon heqjen e kufizimit për mandatin presidencial

PEKIN, 25 SHKURT - Partia Komuniste në Kinë, ka propozuar largimin e kufizimit të postit presidencial, hap që i mundëson presidentit kinez, Xi Jinping të qëndrojë në zyrë edhe pas vitit 2023.

Propozimi është raportuar të dielën nga agjencia e lajmeve Xinhua. Kjo agjenci ka thënë se Partia Komuniste kanë propozuar largimin e frazës në

Kushtetutë ku thuhet se presidenti dhe nënpresidenti kinez, "nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme".

Ende nuk është raportuar për detaje të tjera.

Ky propozim ka ardhur para takimit treditor të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, që pritet të fillojë sot (e hënë). Emërimet në poste të larta

pritet të jenë një nga çështjet që do të diskutohen në këtë takim.

Xi ka fituar pozitën e presidentit në vitin 2012 dhe konsiderohet lideri më i fuqishëm në dekada në Kinë. Në muajin tetor, ai ka marrë konfirmimin e Partisë Komuniste për një mandat të dytë si president. Mandati i presidentit në Kinë është pesë vjet.



Publikohet raporti i demokratëve rreth hetimeve të FBI-së

Publikimi i raportit u bë pasi u negociaua në mes të FBI-së dhe kreut të demokratëve në Komisionin për Zbulimin të Dhomës së Përfaqësuesve, Adam Schiff, për informacionin që nuk duhej të publikohej

WASHINGTON, 25 SHKURT - Shtëpia e Bardhë publikoi një version të redaktuar të raportit të ligjvënësve demokratë që kundërshton versionin republikan të tri javëve më parë, ku aludohej se FBI-ja pati abuzuar me autoritetin e saj për të përgjuar. Vetë presidenti Donald Trump u shpreh se raporti i demokratëve është një asgjë.

Publikimi i raportit u bë pasi u negociaua mes FBI-së dhe kreut të demokratëve në Komisionin për Zbulimin të Dhomës së Përfaqësuesve, Adam Schiff, për

informacionin që nuk duhej të publikohej.

Teksti u hartua nga ligjvënësi demokrat si kundërpërgjigje ndaj raportit të ligjvënësit republikan Nunes ku thuhet se FBI-ja pati fshehur lidhjet e demokratëve me materialin kërkimor që u përdor për të siguruar një mandat survejimi për Carter Page, ish-këshilltar i fushatës elektorale Trump.

Demokratët pretendojnë se versioni i republikanëve fsheh dhe keqinterpretin faktet. Ata gjithashtu akuzojnë presidentin Trump se nuk mori në konsid-



eratë shqetësimet për nxjerrjen e të dhënave sensitive në raportin republikan, ndërsa e vonoi botimin e raportit demokrat për arsye politike dhe jo të sigurisë kombëtare.

Presidenti Donald Trump shkroi në "Twitter" se:

"Përgjigja e demokratëve ndaj abuzimit të qeverisë me përgjimet është një dështim i plotë politik dhe juridik. Vetëm sa konfirmim gjithë gjërat e tmerrshme që u bënë. Tepër e paligjshme"! Po kështu, presidenti Trump u

lidh nëpërmjet telefonit me një emision të kanalit Fox News, ku përsëriti akuzat ndaj ligjvënësit demokrat Schiff për rrjedhje informacioni dhe fabrikim lajmesh. Ndërsa për vetë raportin e demokratëve, presidenti Trump u shpreh se "raporti është një asgjë".

Botimi i raportit u bë ndërsa shefi i stafit i Shtëpisë së Bardhë, John Kelly, po shtrëngon rregullat për certifikatat e sigurisë, pasi u mësua se një ish-anëtar i stafit nuk kishte marrë ndonjëherë certifikatë sigurie. Disa nga këshilltarët më të afërt të presidentit, përfshirë dhëndrin e tij Jared Kushner, janë duke punuar me certifikata të përkohshme sigurie. Presidenti është shprehur se do ta mbështesë Kelly nëse ai vendos që Kushner të mos ketë qasje në dokumente tepër sekrete.

Koreja e Veriut është e hapur për bisedime me Shtetet e Bashkuara



SEUL, 25 SHKURT - Zyrtarët e Koresë së Jugut thonë se Koreja e Veriut është e hapur për bisedime me Shtetet e Bashkuara, pavarësisht njoftimeve të fundit luftarake nga Pheniani.

Zyra e presidentit koreano-jugore tha se komentet u bënë në një takim mes presidentit Moon Jae dhe delegacionit të Koresë së Veriut në Lojërat Olimpikë Dimërore dhe se të dyja palët ranë dakord që marrëdhëniet ndër-koreane dhe marrëdhëniet e Koresë së Veriut me Shtetet e Bashkuara duhet të zhvillohen paralelisht.

Më parë në një deklaratë nga

agjencia zyrtare e lajmeve e Koresë së Veriut KCNA thuhet se sanksionet e fundit të ShBA-së kundër Koresë së Veriut përbëjnë një 'akt lufte'.

Deklarata akuzon Shtetet e Bashkuara për ngritjen e tensioneve në gadishullin Korean dhe vuri në dukje se Pheniani zotëron armë bërthamore për të përballuar kërcënimet e Uashingtonit.

Presidenti amerikan Donald Trump njoftoi të premten ato që i quajti sanksionet 'më të mëdha ndonjëherë' ndaj Koresë së Veriut dhe kërcënoi një 'fazë të dytë' nëse masat nuk janë efektive.

Sanksionet janë vendosur

kundër një person, 27 kompanive dhe 28 anijeve të regjistruara në Kinë dhe shtatë vende të tjera me qëllim të eliminimit të tregtisë së paligjshme të Koresë së Veriut. Ato bllokojnë asetet e mbajtura nga kompanitë në ShBA dhe i ndalojnë qytetarët amerikanë të bashkëveprojnë me ta.

Që nga gushti i vitit të kaluar, ShBA-ja ka ndihmuar në vendosjen e tri seri sanksionesh nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Presioni nuk e ka ndaluar Phenianin të kryejë prova të tjera bërthamore dhe me raketa.

Me marshe në Moskë përkujtohet kritiku i Kremlinit, Boris Nemtsov

MOSKË, 25 SHKURT - Në disa qytete të Rusisë të dielën është protestuar, si shenjë përkujtimi për kritikun e Kremlinit dhe ish-zëvendëskryeminstri, Boris Nemtsov.

Marshet janë mbajtur në shumë qytete në Rusi, pak para shënimit të përvjetorit të tretë të vrasjes së Nemtsov, vrasja e të cilit është dënuar ndërkombëtarisht dhe ka shfaqur rrezikun për rusët që

kundërshtojnë Kremlin.

Nemtsov, kritik i zëshëm i presidentit rus, Vladimir Putin është qëlluar për vdekje në Moskë, më 27 shkurt 2015. Mijëra persona kanë marshuar duke mbajtur në dorë pllakatet me thirrjet, "Demokraci është e drejta për të përjashtuar autoritetet", dhe "Unë jam kundër aneksimit të Krimesë", referencë e vendimit të Rusisë për të aneksuar

Krimenë nga Ukraina.

Disa protestues kanë bërtitur, "Putini është hajni" dhe "Ne jemi Boris Nemtsov". Një grup rus, që vëzhgon numrin e turmave në protesta publike, ka vlerësuar se rreth 7 600 persona kanë marrë pjesë në marshin në Moskë.

Kritikët e Kremlini shpesh akuzojnë autoritetet për ulje të numrit të protestuesve.



Lola Kaltrina lansoi këngën "Piktura"

Lola Kaltrina është muzikantja e re, e cila dita-ditës është duke avancuar si në aspektin muzikor ashtu edhe në atë shkollor dhe sportiv. Ajo së fundi ka lansuar këngën "Piktura".


Lola Kaltrina u lind më 21.05.2010 në qytetin e Pejës. Rrjedh nga një familje akademike dhe muzikante. Ajo vijon mësimet në klasën e dytë në shkollën "Hysni Zajmi" në

Vrellë. Është nxënëse e shembullore dhe flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe gjermane. Lola është pjesëmarrëse e festivalit "Lyra Fest" në Gjakovë.

Ajo vitin e kaluar mori çmimin e dytë në këtë festival. Lola është aktive edhe në sport.

Ajo është basketbolliste e KF Istogut.

Pasion ka këndimin, vallëzimin, pianon, e sidomos librat për fëmijë në gjuhën gjermane.



ShBA-ja, irlandezët pa dokumenta të Bostonit

Megjithëse numri i deportimeve në total ishte ulur në vitin 2017, numri u rrit për shumicën e vendeve, përfshirë Irlandën. Numri total i deportimeve - 34 - është më i vogël se sa ai i vendeve të tjera, por paraqet një rritje prej 31 për qind nga viti 2016, mjaftueshëm për të shkakuar panik në një komunitet që në vitet e fundit nuk është mësuar me kontrolle të tilla.

"Ai nuk mund të dëbojë njerëz jashtë vendit. Ne e kemi ndërtuar këtë vend!"

Por presidenti Trump po deporton irlandezët pa dokumenta dhe kjo është ndjerë fort në Boston, ku trashëgimia irlandeze ndihet shumë. Ata në rrezik nuk e dinë se kujt mund t'i besojnë dhe nganjëherë bien pre e depresionit, shpjegon Kieran O'Sullivan, një këshilltar i emi-

gracionit në Qendrën Baritore Irlandeze në Boston.

"Ka njerëz që kanë frikë të ngasin makinën, edhe pse u duhet të shkojnë në punë me makinë. Disa njerëz kanë frikë të kenë kujdes shëndetësor. Kohët e fundit te ne erdhi një grua e cila ishte viktimë e dhunës në familje. Dhe kështu, ndodh që viktimat kanë frikë të shkojnë në polici, sepse i merret vesh statusi i imigracionit".

Thomas Callahan, një zdrukthetar pa dokumente, shqetësohet për mundësinë e arrestimit të tij, dhe burgosjes me javë ose muaj. Por ai thotë se nuk e kanë dyshuar për 16 vjetët që ka qenë në Shtetet e Bashkuara.

"Shumica e amerikanëve, kur je duke punuar, nuk të shohin si një imigrant i paligjshëm. Ata nuk e dinë statusin e imigra-



cionit, dhe supozojnë se je këtu ligjërisht vetëm se flet anglisht mirë dhe je i bardhë...nuk dinë gjë për çështjen e dokumentave" thotë ai.

... një avantazh, të cilin Callahan pranon se shpesh nuk e kanë grupet e tjerë të imigrantëve. "Edhe njerëzit me status ligjor,

fakti që ata janë nga Lindja e Mesme ose ndoshta një vend afrikan, ata e ndjejnë se përjetojnë diskriminim më hapur" thotë Veronica Keys, e Qendrës Baritore Irlandeze.

Zonja Keys thotë se ka një ndarje mes brezash në mënyrën se si irlandezët e shohin imigracionin

e paligjshëm. Shpesh, emigrantët më të hershëm, të cilët kanë ardhur në vend sipas ligjeve dhe rrethanave të mëparshme, kanë më pak tolerancë, thotë ajo.

Por historia e gjatë e imigracionit ka bërë që shumë irlandezë të ndjejnë se e kanë të drejtën të jetojnë në Shtetet e Bashkuara.

Të tjerë besojnë se emigrantët e rinj nga vendet e tjera meritojnë gjithashtu një jetë në Amerikë.

"Unë e di se shumë prej tyre po i arratisen situatave të vështira nga vendet e tyre, dhe ku tjetër mund të shkojnë kur ndodhin gjëra të tilla?"

Vlerësohet se numri i irlandezëve të pa dokumentuar që aktualisht jetojnë në Shtetet e Bashkuara varion në mënyrë drastike, nga 10,000 në 50,000. (gazeta-Shqip.com) / VOA

Ushtria e Kuqe, 100 vjet nga armata e ish-Bashkimit Sovjetik

Nja dy cigare dhe hip në kamion. Katër kilometra e gjatë është rruga nga fshatrat përreth qytezës brandenburgase Erkner deri te stacioni i trenit. Një rrugë që nuk bëhet dot gjithnjë më këmbë a me biçikletë. Kështu që ishte shumë komode, kur atypari kalonte ndonjë kamion i kazernave të ushtrisë ruse: "Mjafton t'u jepje ndonjë cigare dhe të merrnin me vete në karroceri", kujton fotografii Christian Thiel që është rritur në këtë zonë, në kohën e pushtimit sovjetik gjatë viteve 1950. Gati një gjysmë shekulli, prej vitit 1945 deri kur u tërhoqën, në gusht të vitit 1994, Ushtria Ruse ishte stacionuar në pjesën lindore të Gjermanisë. Ajo ishte pararoja ushtarake e sundimit sovjetik e drejtuar kundër Evropës Perëndimore.

"Për rusët ne ishim kafshë të egra"

Marrëdhëniet me popullsinë civile u normalizuan vonë. Në

kryesore të të cilave ishin gratë. "Rusët mund të bënin tani me ne çfarë të donin", kujton berlinezja Eva Schliep ditët e para pas pushtimit të Berlinit në prill 1945, në gazetën e përditshme "Die Welt". "Përdhunime, ekzekutime dhe plaçkitje dhe veç kësaj një urrejtje e pakufishme ndaj gjermanëve që u kishin shkaktuar aq shumë vuajtje ruseve na e bënin jetën shumë të vështirë." Numri i grave të shfrytëzuara dhe përdhunuara gjatë muajve të parë të pushtimit rus nuk dihet saktësisht. Hamendësimet janë shumë të ndryshme: nga 200.000 deri në dy milionë.

Armij të urreyer

Në vitin 1945 Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania kishin një armiqësi të urreyer. Edhe themelimi i Ushtrisë së Kuqe kishte qenë rezultat i një humbjeje shkurajuse që kishin pësuar rusët në Luftën e Parë Botërore. Në vitin 1917, ushtria



mëdha të terrenit të tij - një humbje poshtëruese që nuk duhej të përsëritej edhe një herë kështu.

Nga kazma te pushka

Kështu edhe Trotzki, në janar

ndërtoi atë mbi bazën e ushtrisë cariste që nuk ishte shpërbërë ende, prej së cilës rekrutoi edhe shumë komandantë. "Përqindja e papërfillshme e analfabtëve ndër rekurtë sa vjen e ulet", shënon ai në vitin 1934. "Gjatë vitit të kaluar, vetëm në Moskë kanë marrë certifikatat e qitësve 50 000 punëtorë nga profesionet civile dhe shkollat."

Spastrimi i madh

Sowjetrepublik Leo Trotzki (picture-alliance/akg-images) Për Stalinin ushtria me shumë oficerë që kishin shërbyer në kohën e carit, ishin të rrezikshëm. Themelusi i saj ai e kishte detyruar të mërgonte qysh në vitet 1928/29. Në vitin 1937 ai vendos të bëjë një "spastrim": Shkarkoi afro 35 mijë oficerë, gati gjysmën e tyre i dërgoi në internim. Shumë syresh i ekzekutoi. Pas Luftës së Dytë Botërore, Ushtria e Kuqe u bë ushtria më e madhe e botës. Ajo përfshinte 170 divizione këmbësorie, 35 divizione tankesh dhe 58 divizione arti-

lerie, afro katër milionë e gjysmë ushtarë ishin me armë në dorë. Por ushtria e rezervistëve ishte shumë më e madhe, afro 30 milionë vetë.

Tërheqja nga Gjermania

Edhe arsenali në tokën gjermane ishte shumë i madh. Kur Ushtria e Kuqe u largua nga RDGJ-ja në vitin 1994, ajo la pas një rrjet me 1.500 impiante ushtarake. Rreth një gjymë milionë ushtarë u kthyen në shtëpi. Ata morën me vete afro 4.300 tanke, 100.000 kamionë, 3.600 armë dhe 180 sisteme raketore. Gjermanisë, e cila sapo ishte bashkuar pak më parë, kjo i kushtoi shumë: ajo mori përsipër një pjesë të mirë të kostove të transportit të impianteve ushtarake, përafërsisht 7,5 miliardë marka gjermane (afro katër miliardë euro). Shumë prej aparaturave janë ende në përdorim, si pjesë e inventarit të ushtrisë së shtetit pasardhës të Bashkimit Sovjetik, Federatës Ruse.

(gazeta-Shqip.com)



vitin 1945, Gjermania naziste sapo kishte humbur Luftën e Dytë Botërore, gjermanët kishin shumë frikë nga ushtarët sovjetikë. Me të hyrë në Gjermani dhe pasi okupuan ndërtesën e Rajhstagut, ushtarët rusë e bënë të qartë se kush do ta kishte pushtetin këtej e tutje. Me të marrë sovjetikët më 1 maj ndërtesën e Rajhstagut ata ngritën aty flamurin e Bashkimit Sovjetik. Fotografia rus Jewgeni Ananjewitsch Chaldei e ka fiksuar skenën me kamera. Edhe pse skena mund të jetë sajuar më pas, kjo fotografi është bërë tashmë ikonë e historisë së fotorafisë. Në fillim, nën flamurin e kuq të Bashkimit Sovjetik sundonte dhuna dhe aribariteti, viktimat

gjermane kishte pushtuar pjesë të tëra të perandorisë cariste që ishte në rrënim e sipër. Në dhjetor të po atij viti u takuan përfaqësues të dy shteteve për të bërë negociatat e paqes në qytetin Brest Litovsk, 180 km larg Varshavës. "Rrethanat historike", do të shkruante Leo Trotzki, që disa muaj më pas organizoi themeleimin e Ushtrisë së Kuqe, "kishin bërë që të deleguarit e regjimit më revolucionar që ka parë historia të ulen në një tryezë me përfaqësuesit diplomatikë të kastave më reaksionare ndër të gjitha klasat qeverisëse". Kjo kastë reaksionarësh u diktoi rusëve një paqe shumë të disfavorshme. Bashkimi Sovjetik duhej t'i dorëzonte Perandorisë Gjermane pjesë të

1918, nisi të ndërtonte një ushtri sovjetike "të kuqe". Ai e



Cardi B ia blen të dashurit një qafore 250 mijë dollarësh



Reperja Cardi B nuk po kursen fare nga paratë që po i fiton në muzikë. Ajo së fundi ka shpenzuar 250 mijë dollarë që t'ia blejë të

dashurit të saj, reperit Offset, një qafore të re diamanti. Kjo dhuratë ka 150 karat dhe është bërë nga argjendari i famshëm Elliot Avianne.

Robin Thicke bëhet sërish baba



Robin Thicke dhe April Love Geary janë bërë prindër. Këngëtari 40-vjeçar ka njoftuar përmes rrjetit social "Instagram" se ai dhe e dashura e tij 23-vjeçare

tashmë kanë një vajzë, të cilën e kanë pagëzuar me ermin Mia Love Thicke. Gjithashtu, Robin është baba edhe i një djali shtatëvjeçar me ish-bashkëshorten Paula Patton.



Ndërron jetë aktorja e famshme indiane

Sridevi Kapoor, aktorja e famshme e Hollywoodit, ka ndërruar jetë në moshën 54-vjeçare, pas një sulmi. Aktorja indiane, e cila njihet thjesht si Sridevi, ka ndërruar jetë në

Dubai, ku ishte e pranishme për një dasmë familjare. Sridevi ka qenë pjesë e më shumë se 150 filmave, duke përfshirë klasikët indianë "Mr India", "Chandni", "ChaalBaaz" dhe "Sadma".

Brody Jenner do që të pajtohet me Kylie Jennerin




Brody Jenner do që t'i rregullojë marrëdhëniet me Kardashianët, sidomos me motrën e tij të mesme, Kylie Jenner. Sipas "TMZ", Brody nuk e ka parë akoma vajzën e porsalindur të

motrës së tij, por ka shumë dëshirë ta shohë. Kardashianët i kanë shkëputur marrëdhëniet me Brodyn që prej divorcit të Kris nga Caitlyn, po ai do që ky fakt të ndryshojë.

KUMTESË

Kosova dhjetëvjeçare dhe



Prof. dr. Emin KABASHI

Përkufizimi

Nuk dua të flas sot këtu, në Rahovecin e lashtë, për identitetin kombëtar të Kosovës, sepse ajo është çështje që dihet, sepse është pjesë e historisë sonë, e cila nuk ka filluar me ne, as nuk përfundon me ne, sepse përbërësit e identitetit kombëtar janë pjesë e bërthamës sonë kombëtare sepse, në fund të fundit, ka kaluar koha e krijimit të kombeve të reja. Sigurisht, si kudo në botë, edhe në Kosovë e dinë, se shekulli i nëntëmbëdhjetë ishte shekulli i krijimit të kombeve, pra shekulli kur është krijuar edhe kombi shqiptar. Por, dua ta flas për një çështje thelbore.

Nuk besoj se ka vend në botë, që emërtimi i popullit, i vendit, i gjuhës, simboli i flamurit, të ketë vetëm një përfundues, siç është rasti i Kombit shqiptar. Po kështu, edhe në histori, folklor, etnografi, arkeologji, numizmatikë-monedhat e lashta, zbukurime armësh, djepi, vegla muzikore, besime, e të tjera, të ketë po këtë përfundues dalluese: Shqiponjën!

Sot, sipas albanologëve, emërtimi "shqiptar" nuk e tejkalon periudhën e mesjetës, mirëpo, në anën tjetër, lidhet me lashtësinë, me gojëdhënë e Pirros kur u drejtohet nënshtetasve të tij, se "ata ishin bijtë e shqiponjës".

Hyrje

Nuk dua të flasë, si është bërë Kosova shtet, me politikë paqësore, apo me luftë të armatosur, se a janë bërë gabime, apo nuk janë bërë, se cila ishte klasa politike që e bëri shtet Kosovën, se kush na ndihmoi, apo kush nuk na ndihmoi.

Por, dua të flasë, se liria e Kosovës, siç edhe liria e Arbërisë së Mesjetës, pra Arbëria e Motit të Madh, siç i thonë arbëreshët e mi periudhës së Skënderbeut, më tutje, siç edhe luftërat për pavarësinë e Shqipërisë, më 1908-1912, janë projekte të popullit shqiptar. Do të thotë, sikur të mos

ishin projekte historike të popullit shqiptar, as nuk do të vinte kush të na ndihmonte, as nuk do të kujtohej kush se a ishim të robëruar. Kosova ishte e pushuar dhe e robëruar që nga viti 1913, edhe me nënshkrimin e Fuqive të Mëdha të Evropës së kohës, por askush nuk ishte kujtuar asnjëherë që ta hiqte robërinë e saj, derisa u kujtua vetë populli shqiptar dhe me armët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, hoqi robërinë dhe sot është shtet i moshës dhjetëvjeçare.

Nuk dua të flas as për Rezolutat e Kombeve të Bashkuara, as për vetot në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, të Rusisë, apo Kinës, sepse janë gjera që nuk e bëjnë lirinë e një populli. Por, dua të flas, se kurrë, në historinë e popullit shqiptar, asnjë rezolutë, e asnjë veto nuk e ka sjellë lirinë tonë, se asnjë populli në histori, andaj as shqiptarëve, askush nuk ia ka falur lirinë, as me rezoluta, as me veto, as me pranime apo mospranime.

Lirinë e fitojnë vetë popujt, me bërthamën e tyre kombëtare, por me bukën e popullit, pastaj vijnë të tjerë që ta ndihmojnë, apo ta pengojnë. Do të thotë, pa krijimin e bërthamës kombëtare të luftës për liri, nuk krijohet liria e një populli, në këtë rast liria e popullit shqiptar të Kosovës, askush nuk vjen të luftojë për lirinë tënde dhe askush nuk vjen të sakrifikojë për ty.

Kosova dhjetëvjeçare dhe Evropa

Nuk dua të flas për asnjë ngjarje të kaluar historike, as për Traktatin e Shën Stefanit, më 3 mars 1878, ku Perandorisë Osmane ju morën nga Rusia cariste për aleatët e saj, mbi 80% e territoreve në Gadishullin ballkanik, nuk dua të flas as për Kongresin e Berlinit, më 13 qershor 1878, i cili fillimisht ishte thirrur për të rishikuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, nuk dua të flas as për Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në dhjetor të vitit 1912, as për Konferencën e Paqes në Paris, më 1921, sepse janë çështje që dihen historikisht, pa marrë parasysh si i ka shpjeguar shkenca jonë historike.

Por, dua të flas për idealin e lirisë së popullit shqiptar, në strukturën kombëtare e të cilit përherë kishte një bërthamë kombëtare, që nuk e pranonte robërinë, që nuk njihte copë-

timin e tokave shqiptare, që nuk njihte pushtetet hegjemoniste, që përherë kërkonte vetëm të drejtën dhe lirinë e popullit dhe vendit të tij.

Po ashtu, dihet se nëpër të gjitha këto periudha kohore, nëpër të gjithë këto ngjarje të mëdha historike, duke mbrojtur tokat dhe lirinë e tij, populli shqiptar, me atdhetarët dhe tradhtarët e tij, që nuk mungojnë asnjëherë, ishte dëmtuar shumë, ishte pakësuar numerikisht, sa ndonjëherë i ishte ndërprerë edhe zhvillimi i natyrshëm biologjik.

Nëpër këto lakadredha të historisë, ka ecur edhe pjesa e popullit shqiptar, që ishte copëtuar nga trunghi i atdheut, më 1913, kurse më vonë ishte shpërndarë në disa mini shtete të Ballkanit, jo vetëm të mbahej më lehtë i robëruar, por edhe të pakësohej e të asimilohej më shpejt.

Prandaj, dua të flasë, se një ditë, pas qëndresës më shumë se tetëdhjetëvjeçare, bërthama kombëtare që kishte kalitur idealin e luftës për liri, e thirri popullin në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 27 nëntor të vitit 1997. Andaj, në pjesët e gjeografisë së atdheut, që kishte mbetur jashtë Shqipërisë politike, u zhvilluan tri luftëra çlirimtare, që secila me peshën e saj historike, kanë hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar. Falë këtyre luftërave çlirimtare, sot Kosova është shtet dhjetëvjeçar. Dhe është i tillë, deshën apo nuk deshën të gjithë shqiptarët, deshën apo nuk deshën qendra të ndryshme ndërkom-bëtare.

Proceset historike shqiptare dhe politika e ditës

Nuk dua të flas për politikën shqiptare të ditës, kudo që bëhet ajo, në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup, në Preshevë, në Ulqin, në mërgatën e madhe shqiptare, apo nëpër odat dhe kafenetë tona. Nuk dua të flas për arsyen e thjeshtë se politika zyrtare shqiptare e ditës, asnjëherë nuk ka hapur rrugë për proceset e mëdha historike, asnjëherë nuk ka krijuar një program kombëtar me peshë historike, asnjëherë nuk e ka shfaqur botërisht, se i janë marrë më shumë se gjysma e gjeografisë së tij dhe ka mbetur me më pak se gjysmën e popullit të tij.

Por dua të flas për luftën çlirimtare që është veprim historik

në jetën e popujve të robëruar, andaj edhe në jetën historik të popullit shqiptar. Falë këtij veprimi historik, që ka bërë Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot Kosova është shtet dhjetëvjeçar. Disa iluzionistë shqiptarë, thonë se ky është shteti i dytë shqiptar, por ka edhe të tjerë që thonë se në Ballkan janë dy shtete e gjysmë shqiptare, kuptohet duke futur këtu edhe shqiptarët nën Maqedoninë që po bëhet popull shtetformues. Ka edhe të tillë që thonë se shqiptarët nuk kanë një Program Kombëtar, por harrojnë se Manifesti i Madh Kombëtar i Sami Frashërit, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", projekti i madh i Rilindjes sonë Kombëtare dhe i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, edhe sot e kësaj dite nuk është realizuar. Kur të realizohet ky projekt madhor, kur të bëhet realitet, atëherë historia i mëson shqiptarët se cilat veprime janë të duhura për të ecur tutje.

Pra, mirë, nëse mund të thuhet mirë. Sado që iluzionet janë të dëmshme për veprimin historik në jetën e një populli, ato kanë edhe një barrë të psikologjisë së robit, ngase u mjaftojnë gjysmat, ose që u kanë lënë të tjerët, siç është rasti me Shqipërinë politike, ose ato që kanë fituar me luftë çlirimtare, nuk është rasti me Kosovën dhe shqiptarët nën Maqedoninë. Por, realizimin e përfundimit të procesit historik që ka hapur lufta çlirimtare, që është bashkimi kombëtare, nuk e bëjnë.

Nuk dua të them asnjë fjalë, sidomos sot, për fjalorin e politikës së ditës, kudo që zhvillohet ajo, në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup, në diasporën e madhe shqiptare, nëpër oda dhe kafene, sepse mund të numërohen në gishtat e dorës sa herë është përmendur procesi i bashkimit kombëtar, që është proces historik dhe është i pashmangshëm, por edhe për faktin se sot jemi në ditë kremteje, ngase Kosova jonë është e moshës dhjetëvjeçare si shtet i pavarur dhe sovran. Nuk dua të flasë, as për kategoritë e pavarësisë e të sovranitetit, qoftë edhe për shkak të nivelit kulturor të gjuhës së shtypit dhe të politikës sonë, por e di saktësisht se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe është në rrjedhën e procesit historik që ka hapur lufta çlirimtare për bashkimin kombëtar.

Nuk dua të flas as për qëndrim-

in e shumicës së shteteve evropiane, sepse qëndrimin e tyre e ka shpallur mrekullisht Ambasadori i parë i Shqipërisë së pavarur etnike, të Ismail Qemalit, të vitit 1912, në Mbretërinë e Bashkuar, Mehmet Konica, kur në fillim të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913, vetëm me ndihmën e miqve të tij, lordëve anglezë, kishte arritur ta pranonte kryeministri Eduard Grei, vetëm për 15 minuta, që ishte edhe kryesues i Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913. (*Ambasadori Mehmet Konica futet në zyrën e tij, por ai jo vetëm nuk denjon t'ia japë dorën, por as ta kthente kokën nga dritarja ku shikonte, sa duket, rrugët e Londrës së asaj kohe.

-Fol, -i thotë kryeministri Grei, -por vetëm për kufijtë mos fol. -Jo, -ia kthen Ambasadori Mehmet Konica, -kam ardhur të të përcjellë porosinë e kryeministrit tim, z. Ismail Qemali, e të ju them se në Shqipëri është bërë një zbulim i një miniere të madhe ari, andaj kryeministri im, ka dëshirë që Britania e Madhe të jetë koncesionare. Kryeministri Grei, kthehet, ia jep dorën, e fton të ulet, se nuk kishte kuptim të bisedohej në këmbë, e të tjera. Për të mos e zgatur. Kur kalon 15 minuta, Ambasadori Mehmet Konica ngrihet në këmbë, dhe i thotë kryeministrit Grei, se në Shqipëri nuk ishte zbuluar asnjë minierë, as e madhe as e vogël e arit, por vetëm deshi ta shikonte qëndrimin e një fuqie të madhe evropiane, si do të reagoonte, nëse do të kishte interes ekonomik në vendin e tij. Dhe del nga zyra. Nuk dua të flasë, as për historinë e Kosovës, që po e shkruan Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, as për atë që e ka shkruar Akademia e Shkencave e Tiranës, thuajse kemi dy histori, ngase absurdi ndodh kur politikës dhe shkencës së ditës, i mbushet mendja se një popull ka dy histori të ndryshme.

Por, dua të flas për faktin se pa marrë parasysh se çka thotë politika dhe dija shkencore e ditës, Kosova sot është shtet dhjetëvjeçar, por ajo që është kryesorja, ajo përfundimisht është çliruar nga pushtimi sllav. Nuk dua të flas për Gjykatën Speciale, sepse kjo nuk është hera e parë, kur edhe ata që na kanë ndihmuar, kanë më shumë interes të mos prishen me Rusinë, e të tjerë, se sa a dëmtohet, apo nuk dëmtohet

identiteti kombëtar

një pjesë e popullit shqiptar që ka luftuar për lirinë e tij.

Por, dua të flas dhe ta theksoj me këtë rast, se asnjë gjykatë e botës, nuk mund t'ia marrë lirinë një populli që ka zhvilluar luftë çlirimtare, asnjë gjykatë në botë, nuk mund ta zhbëjë luftën për liri të një populli, pa marrë parasysh sa dëmtohen individë të caktuar. Prandaj, Kosova sot është shtet i pavarur dhe sovran, edhe pse moshën e ka vetëm dhjetëvjeçare.

Nuk dua të flas as për korrupsionin e një shtrese të caktuar të atyre që bëjnë politikën e ditës, bashkë me evropianë të caktuar, sepse pas 12 qershorit

të vitit 1999, kur kapitullon ushtarakisht Serbia pushtuese, e këndeje, secili individ mban përgjegjësi për veprimet e tij në politikën e ditës.

Por, dua të flasë, me shumë zë, se askush nuk mund ta nëpërkëmbë luftën çlirimtare të një populli, ngase historia nuk krijon kope heronjsh, por krijon një emër-simbol, siç e ka krijuar Komandantin Legjendar Adem Jasharin. Si dhe, se ardhmërinë e lirisë së një vendi që ka zhvilluar luftë çlirimtare, nuk e bën politika e ditës, por Dëshmorët e Kombit, që janë pjesë e mbamendjes sonë historike.

Përfundim

Sot në Rahovecin e lashtë, në territorin e të cilit, kur ishte apo nuk ishte komunë, asnjë ngjarje historike nuk është zhvilluar pa pasur pjesëmarrës edhe nga kjo anë. Prandaj, edhe Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në këtë anë, jo vetëm kishte djem dhe vajza që u bënë ushtarë të lirisë, por ata që kanë rënë për liri, Dëshmorët e Kombit, e kanë bërë edhe këtë pjesë të gjeografisë shqiptare, pjesë të kujtesës së Atdheut tonë që quhet Shqipëri.

Prandaj, këtu dhe sot, nuk është vendi të flitet për ato që janë

pjesë e jetës së përditshme, sepse ajo dihet, ka halle dhe ka mungesa, ka varfëri dhe ka të papunë, ka të pasur dhe ka hilexhinjë, që e duan Kosovën dhe lirinë e saj, vetëm kur përfitojnë nga ajo.

Sot dhe këtu, është vendi të flitet për moshën e një shteti që është krijuar pas një luftë pesë vjeçare, nga viti 1997-2001, të shqiptarëve të pushtuar dhe të robëruar dhe të lënë pa atdhe, pra, që kishin mbetur jashtë gjeografisë së atdheut kombëtar. Kanë kaluar mbi 402 vjet nga vdekja e Shekspirit të madh. Me Nolin tonë, ai është bërë edhe pjesë e kulturës sonë kombëtare.

Përveç të tjerave, ai na ka mësuar si flasim e të shkruajmë në ditë festash, e si në ditë morti. Këtë mënyrë të shkrimit, ma ka mësuar edhe mua sot, në Rahovecin e lashtë, për të folur për shtetin dhjetëvjeçar të Kosovës.

Ju falëm nga zemra që më dëgjuat!

** Kumtesa është lexuar në shënimin e dhjetëvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Rahovec, në organizim të komunës së këtij qyteti. Autori është këshilltar shkencor në institutin Albanologjik të Prishtinës*



Krizë për artin në Kosovë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Vlerësimi i artit luan një rol shumë të rëndësishëm për kulturën e vendit, ngaqë pranimi i artit në përgjithësi tregon për kulturën që e posedon një vend. Kur ka pranim dhe vlerësim të mirëfilltë anashkalohet kriza në art por, megjithatë, studimet e përgjithshme në këtë domen konstatojnë se ekziston një gjendje jo e mirë në fushën e artit.

Sa i përket krizës në art dhe

arritjeve të reja në këtë fushë, piktorja nga Mali i Zi, Zake Prelvukaj, e cila me pikturat e saj ka depërtuar edhe jashtë vendit, ka thënë për "KosovaPress" se jo vetëm në shtetin e Kosovës, por edhe në shtetet e tjera është krizë për art, plus kësaj ajo ka edhe një kërkesë, që institucionet të përqendrohen më tepër tek të rinjtë, duke konsideruar se ata janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin dhe prezantimin e shtetit tonë.

E pyetur se a vlerësohet arti në bazë të shitjes së pikturave, ajo ka theksuar se kjo mund të konstatohet në bazë të blerësit, duke konsideruar se blerja e pikturave nga një koleksionues nga vendet e jashtme, konsiston në atë se kjo është një arritje kur ka interes nga jashtë Kosova.

Piktorja Zake Prelvukaj ka paralajmëruar risjelljen e një pikturë nga Pikasso, të cilën vite më parë e kishin sjellë në Galerinë e Arteve.

Edhe piktori Ali Alimusaj, i njohur për bagazhin e tij me mbi 30 mijë vepra arti, për 50 vjet që merret me art, ka një preokupim për artin sepse, sipas tij, të bësh art në Kosovë është problem shumë i madh, pasi pasohet nga vlerësimet subjektive, që janë larg mendimit kritik e të saktë. Sipas tij, tregu në Kosovë paraqet një problem të madh për piktorin, ngaqë tregu po ndikon në përshtatjen e piktorëve të rinj, e jo në ruajtjen e

veçorive të mirëfillta të artit që ata e kultivojnë.

Alimusaj ka theksuar se artin në përgjithësi e mbajnë të izoluar. Zake Prelvukaj dhe Ali Alimusaj janë piktorë që kanë një bagazh të pasur me vepra të ndryshme. Ata kontribuojnë edhe në arsim duke e gëzuar statusin profesor në Fakultetin e Arteve. Pritet të vazhdojnë me hapjen e ekspozitave të tjera të reja, për ta promovuar punën e tyre të vazhdueshme në art.



Autor: GAZMEND MORINA - BENI						PJESË E DHOMËS (sh.shq.)	SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTRËMBËRIMIN E ESHTRAVE	E BËRA GATI	NDËRTIM ME TË CILIN E RRETHOJËMË OBORRIN (shq.)	NEGRI, ZEZAK	TEDI ALVES	EPOKA E RE	E PALËVIZSHME	VITI I RI KINEZ	TOKA E BUKËS	KLUBI FUTBOLLI NË ITALI		
MË VJEN GJUMË DUKE NDEJUR, FLE PAK DUKE NDEJUR												SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA						
EMËR I VJETËR PËR DUBROVNIKUN												AKTORJA AM. HATCHER MBETURINË E NJË KAFSHE PARAHISTORIKE						
FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË											VDEKJEPRURËS ZET, OKSIGJEN							
HISTORIANI ROMAK LUKRECI (shq.)										ALLAHU, PERËNDIA SHKRONJA TË NJËJTA					ZANORE KAPTULL I FUNDIT I NJË VEPRE LETRARE			
BABAI									MOTOÇIKLISTI I NJOHUR VALENTINO E PËRZIER					EMPOLI, NAPOLI KËNGËTARI VLADI				
KALORËS MESJETAR											I ZË ME DORË SILLEM LART E POSHTË					ZVOGËLIMI DERI NË PIKËN MË TË ULËT		
THIRRJE E MYEZINIT										GJELBËRIM ZANORE								
EPOKA E RE	FUTBOLLISTI YNË I TALENTUAR NË FOTO (WERDER BREMEN)	PJESËTARET E NJË FISILIR	GJUMI I THELLË (med.)	ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI	RITUAL	SHKRONJA XXVIII & VIII ADRIAN KRASNIQI		AJËR (huaj) PROVIM				DËSHIROJ	INDIAN LAW INSTITUTE REGJISORI MINAROLLI					
MEKANIZËM QË SHËRMBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA							MISSISSIPPI TUNDR KINGS ENËT E POSAÇME KU MBAHËT HIRI I TË VDEKURIT			TËRËSI E GJALLESAVE NË TOKË VARGJET E PËRPUTHURA								
SHALQI (shq.)															GABRIEL IGLESIAS KYÇ			
LLOJ DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS JUGORE (sh.shq.)												PËREMËR VETOR QESËNDISËS			BASHKËT. TER, KA			
BASKETBOLLISTI TURK OMER													FUTBOLLISTI SHQIPTAR LILA REGJISORJA SHQIPTARE ELEZI					
SHKRONJA TË NJËJTA										LLOJ HELMI LUFTE NJË PLANET					EDA ZARI DY ZANORE			
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLEDHJEJE										KUJDESTAR (jurid.) RRIPI I LLAMBËS				PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE FËMIJË I VOGËL				
BËRTHAMOR											MODELJA AMERIKANE TAYLOR HUMORISTI BESIM				MOLDE DIREK I ÇATISË			
BASHKËT.										CA SHTET NË EVROPË (pashq.)					TITAN JETËSHK-RIMET			
SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM, BESE														QË ËSHTË PREJ METALI, I METALTË KUMBARË		DAFINË BASHKËT.	FUQI, FORCË (bised.)	
KARBON, AMPER											EDUARD NORTON U ARRATISË NGA BURGU			FLEGËR ZOC ROSE, BIBË ROSE (shq.)				
LLOJ PAPANALLI														QË SHEH VETËM DOBINË E ÇASTIT OLIVER (shq.)	MARC ANTHONY "TETOVA"	ZANORE GRIMCOVA (bised.)		
EPOKA E RE	NIS TË ZBARDHË DITA ALUMIN					ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN PRODUKT I ZJARRIT				SFOND SHKRONJASH ISMET HASANI								
SHTËPI PLEQSH														HAITI, INDIANA BASHKËT.		E BASHKUAR ISLANDA	SOLISTJA QAZIMI ZANORE	
KUFIZIMI																	I KAPËRDIJ	SHTET (FR.)

E jashtëzakonshme

Fast Food-i më i njohur në botë mbyll dyqanet, ka mungesë pule

Kompania e Fast Food-i, KFC, u ka kërkuar falje klientëve të saj për reklamën e pulave që ka publikuar në gazetat "Sun" dhe "Metro", e cila tregon një kovë të zbrazët që duhet të përmbajë pulë por, në fakt, është e zbrazët dhe ka vetëm disa thërime të vogla. Kompania u detyrua të mbyllë qindra dyqane javën që lamë pas një problemi me furnizuesin e saj të pulave. Tani pothuajse 700 prej 900 dyqaneve të saj në Mbretërinë e Bashkuar janë rihapur.



FOTO E DITES



Një njeri shihet duke hequr qese të plastikes pas riciklimit në Filipine. /Reuters/

E rrallë

Udhëtari që lëshonte gazra detyron aeroplanin të bëjë ulje emergjente

Një ngjarje interesante ka ndodhur në aeroplanin e "Transavia Airlines" në relacionin Dubai-Amsterdam. Pilotit i është dashur të bëjë ulje emergjente në Vjenë, pasi aty brenda kishte plasur një zënkë. Mediet holandeze kanë raportuar se një udhëtar nuk po ndalonte së lëshuari gazra dhe të dy udhëtarët që ishin të ulur afër tij nuk mund ta duronin erën. Pas një zënke, të dy udhëtarët u hoqën nga aeroplani në Vjenë.



BARSOLETA E DITËS



- Doktor, kam një problem. Sa herë që fle natën, shoh ëndrra duke luajtur futboll.
- Merri këto barna dhe nuk ke për të parë më ëndrra.
- Faleminderit, doktor! Po a mund t'i përdor prej nesër, se sonte e kam finalen?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley



Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Nëse e dini se mund të keni besim


tek dikush sot, duhet ta lajmëroni që në orët e para të ditës që ta ketë mundësinë t'ju qëndrojë pranë sa më shpejt.



DEMI

Ngërçet në komunikim me një koleg, ose

mikun tuaj, duhet t'i zgjidhni në një moment tjetër. Sot nuk është dita e duhur për debate.



BINJAKËT

Keni dyshime lidhur me një projekt

që po e zhvillonit edhe me persona të tjerë. Mbase duhet të vlerësoni vetë çdo detaj për të dalë në përfundime.



GAFORRJA

Edhe pse ju rrethojnë mjaft

persona që po ju komplimentojnë sot, duhet të dalloni se kush i ka të sinqerta mendimet e kush jo.



LUANI

Vendimet që do të merrni sot janë shumë

të thjeshta, sepse e keni analizuar në detaje situatën për të cilën duhet të gjeni një zgjidhje.



VI RGJËR ESHA

Këtë periudhë dikush jua ka bërë

gjërat më të vështira, por më mirë kështu sepse keni mësuar si t'i kaloni të vetëm vështirësitë.



PESHORJA

Nëse sot do t'i mbani premtimet që

keni bërë, dita do të shkojë shumë mirë. Familjarët tuaj janë shumë të kënaqur nga progresi që keni arritur.



AKREPI

Për ta përmirësuar të

përditshmen tuaj jo gjithmonë mund të veproni shpejt, por ndonjëherë ka nevojë për refleksim dhe vendime të marra me kujdes.



SHIGJETARI

Jeni në humor sot pasi keni marrë një

lajm të mirë për diçka që mund të ndodhë në mbrëmje, ose në një kohë mjaft të shkurtër.



BRICJAPI

Edhe pse duhet të anashkaloni disa çështje

që i keni mjaft ta përzemërta, do të dini se si ta menaxhoni ditën tuaj për të zgjidhur çdo gjë në kohë rekord.



UJORI

Disa mungesa informacioni në

çështje të caktuara mund t'ju lënë pas në kohë me punët që keni marrë përsipër. Gjithsesi është mirë të informoheni saktësisht.



PESHQIT

Sot do t'ju jepjen mundësi që të tjerët

nuk i kanë pasur, kështu që bëni mirë t'i vlerësoni, megjithëse nuk jeni të kënaqur.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE LEVANTE - REAL BETIS 1 DORTMUND - AUGSBURG GG3+ CAGLIARI - NAPOLI 2

Drita e njofton Llapin me humbje, merr kryesimin në elitë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 SHKURT - KF Drita ka shënuar fitore si mysafire ndaj Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti" dhe e ka marrë kreun në elitën e futbollit të Kosovës, kurse kjo është humbja e parë në këtë kampionat për skuadrën e Llapit. Fitoreve në këtë xhiro iu kanë gëzuar edhe Gjilani, Feronikeli dhe Trepça '89, kurse Vëllaznimi dhe Prishtina kanë luajtur baras. Sot (e hënë) zhvillohet ndeshja e fundit për këtë xhiro në mes të Vllaznisë së Pozharanit dhe Dritës nga Gjilani.

Llapi - Drita 0-1

Derbin e javës së 20 në Vala Superligë e ka fituar skuadra e Dritës, pasi e ka mposhtur në stadiumin "Zahir Pajaziti", Llapin e Tahir Batatinës (0-1). Golin e vetëm skuadra mysafire e ka shënuar në minutën e 49, kur Xhevdet Shabani me një gjuajtje nga brendësia e zonës realizoi për 0-1. Duhet cekur se në minutat shtesë sulmuesi i Llapit, Mirind Daku, ka pësuar një lëndim të rëndë, për çka është dërguar me ambulancë në spital. Me këto tri pikë të reja skuadra e Dritës është ngjitur në krye të renditjes, me 36 pikë, aq sa ka edhe Prishtina në pozitën e dytë, derisa Llapi tashmë është në pozitën e tretë, me 34 pikë.

Gjilani - Liria 1-0

Në ndeshjen tjetër të kësaj xhiroje të zhvilluar të dielën, fituese doli skuadra e Gjilanit ndaj Lirisë nga Prizreni, kurse goli i vetëm i ndeshjes u shënua në minutat shtesë. Autor i golit të fitores ishte mbrojtësi Armend Thaqi, i cili, pas disa mosmarrëveshjeve me kryesinë e Gjilanit, është rikthyer sërish në klub. Pas kësaj fitore Gjilani ngjitet në pozitën e pestë në renditje, me 32 pikë, kurse Liria është e shtata me 31 pikë.

Vëllaznimi - Prishtina 0-0

Derbi i rivalëve të vjetër në mes të Vëllaznimit dhe Prishtinës përfundoi me rezultat 0-0. Vendësit kishin më shumë raste shënimi në ndeshje që solli një spektakël të madh në tribunat e stadiumit, por



rezultati final mbeti ai i fillimit. I pranishëm në këtë ndeshje ishte edhe ish-kapiteni i kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana. Për skuadrën kuqezi kjo pikë është e mirëseardhur në luftën për mbijetesë, kurse Prishtina me dy pikët e humbura e vështirëson garën për titull.

Feronikeli - Flamurtari 1-0

KF Feronikeli, pas humbjes nga Drita, ka arritur t'u rikthehet fitoreve në ndeshjen që është zhvilluar të shtunën ndaj Flamurtarit nga Prishtina (1-0). Golin e fitores për vendësit shënoi mesfushori Albert Dabiqaj në minutën e 15, kurse në vazhdim rastet nuk munguan, por rezultati mbeti i pandryshuar deri në fund të ndeshjes. Kjo fitore e mbanë në garë për titull skuadrën e Ismet Munishit, kurse kuqezinjtë e kryeqytetit do ta kenë shumë të vështirë mbetjen në rangun elitar.

Besa - Trepça '89 0-1

Fitore me rezultat minimal 0-1 ka shënuar edhe skuadra e Trepçës '89 në përballje me Besën e Pejës. Autogoli i shënuar nga mbrojtësi Florent Papuqi doli të jetë vendimtar për ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Shahin Haxhiislami". Në vazhdim të ndeshjes vendësit tentuan ta barazojnë rezultatit, por kapiteni Fetim Kasapi dhe mesfushori Floren Qorraj nuk u treguan të saktë në rastet që i kishin. Besa vazhdon të mbetet në pozitën e dhjetë me 14 pikë, kurse 89-shi zë vendin e katërt me 33 pikë.

VALA Superliga	
Gjilani - Liria	1-0
Llapi - Drita	0-1
Vëllaznimi - Prishtina	0-0
Besa - Trepça '89	0-1
Feronikeli - Flamurtari	1-0
Të hënë takohen:	
Vllaznia - Drenica	

Tabela	
1. Drita	36 pikë
2. Prishtina	34
3. Llapi	34
4. Trepça '89	33
5. Gjilani	32
6. Feronikeli	31
7. Liria	31
8. Drenica	29
9. Vëllaznimi	26
10. Besa	14
11. Flamurtari	11
12. Vllaznia	8

Në kuadër të javës së 21-të takohen: Liria-Feronikeli, Flamurtari-Llapi, Vllaznia-Besa, Drenica-Gjilani, Prishtina-Trepça '89, Drita-Vëllaznimi.

LIGA E PARË	
Vushtrria - Ferizaj	1-1
Vitja - Rahoveci	0-1
Bashkimi - Kika	1-1
KEK-u - Hajvalia	2-1
Ramiz Sadiku - Ballkani	0-0
2 Korriku - Dukagjini	1-1
Fushë-Kosova - Kosova (P)	2-1
Trepça - Onix Banja	0-2

Tabela	
1. KEK-u	42 pikë
2. Vushtrria	35
3. Ballkani	35
4. Onix	33
5. Fushë-Kosova	30
6. Ferizaj	30
7. Vitja	24
8. 2 Korriku	23
9. Dukagjini	22
10. Ramiz Sadiku	22
11. Bashkimi (K)	21
12. Trepça	20
13. Rahoveci	18
14. Hajvalia	17
15. Kika	16
16. Kosova (P)	7

SHKURT

Unitedi triumfoi në "Old Trafford"

Manchester United ka triumfuar në "Old Trafford", pasi e ka mposhtur skuadrën e Chelsea me rezultat 2-1. Pjesa e parë ishte e zjarrtë dhe mysafirët u paraqiten mirë, madje shënuan të parët nëpërmjet Willianit në minutën e 32-të. Shtatë minuta më vonë, vendësit i riktheu në lojë Romelu Lukaku që barazoi shifrat në 1-1. Në pjesën e dytë Unitedi arriti ta shënojë golin e fitores në minutën e 75-të, kur Jesse Lingard realizoi për 2-1. Pas kësaj xhiroje Unitedi e rikthen pozitën e dytë me 59 pikë të grumbulluara, kurse Chelsea është e pesta me 53 pikë.

Mbyllen Lojërat Olimpike Dimërore

Lojërat Olimpike Dimërore Pyeongchang 2018, pas shtatëmbëdhjetë ditësh, kanë përfunduar me parakalimin e atletëve që kanë pasur një performancë të shkëlqyer gjatë këtyre dy javëve të lojërave olimpike. Aty parakaloi edhe ekipi i Kosovës, i cili për herë të parë mori pjesë në këtë garë. Skitari Albin Tahiri zuri pozitën 39 nga 108 garues në disiplinën e sllallomit, ku shumë garues u diskualifikuan. Tahiri garoi edhe në katër disiplinat e tjera si: kombinim alpin (vendi 37), lëshim (50), super sllalom të madh (47), sllalom të madh (56) dhe sllalom (39).

Latifi e fitoi meçin më të rëndësishëm në karrierë

Ilir Latifi ka fituar meçin më të rëndësishëm deri tash në karrierën e tij në Artet Marciale të Përziera. Latifi e mposhti amerikanin Ovince Saint Preux duke e rrëzuar pa ndjenja qysh në raundin e parë. Edhe faqja e UFC-së e kishte cilësuar këtë si meçin më të rëndësishëm në karrierën e shqiptarit, ndërsa pas fitores edhe ai ka thënë një gjë të tillë. Kjo fitore shqiptarit do t'i hapë rrugën për luftën për titull, varësisht në cilën kategori.

Kosova sonte përballët me Lituaninë

Prishtinë, 25 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sonte (e hënë) do të përballë me Lituaninë në kuadër të Dritares së Dytë të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019". Të dielën përfaqësuesja e Kosovës ka zhvilluar stërvitjen e parë në Klaipeda dhe

në mungesë të kapitenit Dardan Berisha, i cili për shkak të lëndimit të muskulit të prapmë të këmbës është dashur të largohet nga kampi i Përfaqësueses për t'u kthyer në Çeki, ku edhe do ta vazhdojë rehabilitimin tek ekipi i tij Basketball Nymburk. Në duelin e parë të luajtur në

Prishtinë ndërmjet Kosovës dhe Lituanisë, fitore bindëse ka regjistruar kjo e fundit me shifrat 99:61. Po në kuadër të Dritares së Parë, basketbollistët e Kosovës janë mundur nga Hungaria në Debrecen me rezultat 84:76. Ndeshja pritet të fillojë nga ora 18:30.



Mbahet gara e Gjmnastikës për Pavarësi

PRISHTINË, 25 SHKURT - Federata e Gjmnastikës së Kosovës (FGJK) ka mbajtur të shtunën garën zyrtare me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Në garën e mbajtur në sallën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë kanë marrë pjesë të gjitha klubet e gjmnastikës së Kosovës me një numër rekord të garueseve. Duhet cekur se në këtë garë Klubi "Elita" nga Prishtina ka shkëlqyer në të gjitha disiplinat, duke fituar edhe shumicën nga vendet e para dhe të dyta. Ky klub rrëmbej 21 medalje.



Besa FamGas pësoi humbje pas katër vjetësh

PRISHTINË, 25 SHKURT - Prishtina i ka dhënë fund serisë së gjatë pa humbje të skuadrës pejane, Besa FamGas, pasi të shtunën mbrëma në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve e mposhti me rezultat 35-29. Ndeshja i takoi javës së 16 të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt), ndërsa u cilësua si derbi i stinorit. Besa kishte fituar 15 ndeshjet e deritashme, ndërsa humbje nuk kishte pësuar në kampionat për rreth katër vjet. Tani të dyja skuadrat i kanë nga 30 pikë dhe pritet luftë e fortë për titull në këtë edicion të kampionatit të Kosovës në hendboll. Prishtinën drejt fitores e ka udhëhequr Deniz Terziqi që shënoi plot 13 gola, kurse te Besa më efikas ishte Tarik Megjiq me tetë gola. Ndeshja ka mbledhur rreth 500 shikues në palestër, ndërsa pjesën e parë e fitoi Prishtina me rezultat 17:12. Në ndeshjen tjetër, Trepça nuk lejoi befasi në "Minatori" duke fituar ndaj Samadrexhës me rezultat 34:28.



Trepça është e pesta me 15 pikë, kurse Samadrexha e parafundit (9) me dy pikë. I. Nuhiu me nëntë gola ishte më efikas te Trepça, ndërsa L. Sadiku

shënoi 11 herë për samadrexhasit. Ndeshjen në mes të Dritës dhe Vushtrrisë e fituan mysafirët me rezultat 36:25.

Golden State, 'leksion' Oklahomës

OAKLAND, 25 SHKURT - Golden State vijon të dominojë në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 112-80 arritur ndaj një ekipi tjetër pretendent si Oklahoma. Pjesa e parë ka qenë e ekuilibruar, por në të dytën vjen shkëputja e skuadrës kampione të NBA-së, e cila triumfoi falë 28 pikëve të Durantit dhe 21 të Curryt, lider në fushë.

Një moment të mirë në kampionat po kalon edhe ekipi i Lakersave, që korri suksesin e dytë brenda 24 orësh, duke mundur 113-108 Sacramenton jashtë fushës. Një ndeshje e hapur deri në fund, me miqtë nga Kalifornia që bënë diferencën në momentet e fundit me Pope, autor i 34 pikëve, ndërkohë që



7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Në sekondat e fundit fiton skuadra e Portlandit, që mundi 106-104 Phoenixin, ndeshje me emocione deri në fund, ku u dallua Lillard, magjik në parket me 40 pikë e 10 rebaunde. Ndërsa 30 pikët e Bookerit për vendësit mbetën për statistikë, raporton "Telesport".

Jashtë fushës fiton edhe skuadra e Bostonit, që mundi 121-112 New York, ndeshje në përgjithësi e dominuar nga miqtë, që korrën fitoren e 42-të sezonale, por qëndrojnë në vendin e dytë në Lindje. Irvingu sërish lider në fushë për Celticsin, autor i 31 pikëve, mbështetur edhe nga Browni me 24.

SHKURT

Skënderbeu fluturon në krye të tabelës

Një autogol i Gojkoviç në minutën e 63-të të takimit vendosi fatet e kryesfidës së kësaj jave të Kategorisë Superiore. Në ndeshjen mjaft të luftuar në Korçë, Skënderbeu vendës doli me pikë të plota, duke mposhtur me rezultatin minimal skuadrën e Partizanit. Me këtë fitore dhe falë edhe barazimit të Flamurtarit, korçarët fluturojnë në krye të renditjes me +13 pikë nga vendi i dytë. Ndeshja u shoqërua nga tensione e nervozizëm mes dy tifozëve, aq sa një grup i vogël i tyre u përlesh në rrugët e qytetit të Korçës. Shkak për zënkën mes tyre besohet se është bërë ndërhyrja e tifozëve të Partizanit në pjesën e biletarisë të rezervuar për korçarët. Policia ndërhyri në vendin e ngjarjes dhe, pasi shpërndau dy grupet e tifozëve, shoqëroi tre persona në komisariat, një tifoz të Skënderbeut dhe dy të Partizanit. Ndërkohë, në takimin tjetër në mes të Teutës dhe Flamurtarit nuk pati gola dhe të dyja ekipet dolën me nga 1 pikë.

Bayerni i shtohet garës për Malcomin

Bayern Munchen është i gatshëm të garojë me Arsenalin dhe Tottenhamin për shërbimet e talentit brazilian Malcom, raporton "The Mirror". Gjiganti i Gjermanisë po kërkon që një kohë zëvendësues për Arjen Robbenin dhe Franck Riberyn dhe ylli i Bordeauxit është kandidat serioz për sulmin e Bayernit.

Neymari tek Reali, kjo është kërkesa e brazilianit

Çdo ditë e më shumë përflitet që Neymari mund të kalojë nga PSG-ja tek madri i Realit. Por, problemi, mesa duket, qëndron tek paga që kërkon braziliani, për të ndryshuar ambient. Edhe pse kanë kaluar vetëm 6 muaj nga kontrata pesëvjeçare që Neymari firmosi me gjigantët francezë, ekzistojnë mundësitë që Reali t'i bëjë sakrificat ekonomike që ta afrojnë brazilianin. Sipas asaj që shkruan "Don Balon", Neymari do të pranonte të shkonte në Madrid në rast se ai do të paguhet më shumë se Ronaldo. Portugezi, në kontratën e re, pritet ta risë pagën e tij në 40 milionë euro, aq sa fiton edhe Messi te Barcelona. Neymari, ndërkohë, kërkon 50 milionë euro.

De Gea kërkon pagë më të lartë në United

Portieri spanjoll David De Gea kërkon ngritje të pagës te Manchester Unitedi. Sipas "The Sun", de Gea beson që e meriton një pagë më të mirë, prandaj ka kërkuar 350 mijë funte në javë për kontratën e re. Në të kundërtën, ai nuk do ta rinovojë kontratën me Unitedin dhe do të transferohet në Real Madrid.

Nëse largohet Donnaruma, Milani e transferon Reinan

Për zyrtarizimin e firmës do të duhen disa muaj, por duket se negociatat e Milanit për një portier me përvojë po shkojnë drejt fundit të suksesshëm. Skuadra kuqezi e ka më shumë se aktuale skenarin e largimit potencial të Donnarummës dhe pikërisht për këtë kërkon të jetë e mbrojtur në portë me një tjetër emër cilësor si Pepe Reina. Gardiani spanjoll i Napolit do të jetë pa kontratë duke nisur nga sezoni i ardhshëm dhe transferimi i tij në "San Siro" bëhet më i lehtë me konsensusin e vetë futbollistit, pa asnjë sforcim financiar. Ka në princip një akord mes Pepe Reinës dhe drejtuesve të Milanit, madje futbollisti ka qenë në "radarët" e skuadrës veriore para se Donnarumma ta firmoste rinovimin.

REZULTATET

Miami - Memphis	115-89
New York - Boston	112-121
Golden State - Oklahoma	112-80
Minnesota - Chicago	122-104
Phoenix - Portland	104-106
Utah Jazz - Dallas	97-90
Sacramento - Lakers	108-113

Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS
A+C+E Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L

Jaffa Champion

Produkte Bio natyrale **MATI**

Djath I Dhisë MATI 300g
Djath Mati MATI 400g
mati com 1 litër
Djath Mati MATI 700g


Mati -com Sh.P.K. është ndërmarje prodhuese vendore e cila prodhon dhe përpunon qumësht të dhisë dhe lopës

Email: mati-com@outlook.com
tel: +386 49 288-340
Kijevë-Malishevë

Fabrika për prodhimin dhe përpunimin e qumështit të Dhisë dhe Lopës

An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

N.N.P.Mati Com SHPK



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zenad Sadiki shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "15 Maji " Donje Lubinje

► Nike Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Romaje

► Sadri Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Vëllezërit Frasheri " Prizren

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info: 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te saloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.-Skenderaj. Tel.044-499-713.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Hasan Osmani, B.I.-Skenderaj. Tel. 044-355-579.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Ensari - Bujk, Drenas. Tel. 049-250-828.

► Lëshoj me qira lokalit përballë spitaleve në Ulpianë në Prishtinë, D8 me 50m2 i përshtatshëm për ordinancë, barnatorë, laborator etj. Për më shumë indor në tel: 044-312-215.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet mbi "Kurritz" në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Hyrja e 7 kati i 9. Banesa ka 45 metra katror me inventar. Banesa lëshohet prej 01.08.2015 çmimi 200 euro pa ndërmjetësues. Numri kontaktues: 044 672 439

*Gjithmon me marr malli për vonën tëm
Urimë dita e pavarësisë!*

RC
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme
fëmijet e mi kanë me qara krenar
me kësi ba në sot.*


*Njëditë ka shumë punë që me arrit a
ka duhet por e di që këtë ka njëz që
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

**10 mesazhe
Kosovës**

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qere anderr për n
Qe prej asaj dite une besoj që puna m
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!
Zemra pushon, vuc këtel!*

**MADE IN
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.